



**QENDRA PËR MBROJTJEN E TE DREJTAVE  
TE FEMIJEVE NE SHQIPERI**

**Children's Human Rights Centre of Albania - CRCA**

**PUNA E FEMIJEVE DHE FEMIJET  
E RRUGES NE SHQIPERI**

**Një studim mbi shfrytëzimin ekonomik dhe punën e detyruar të fëmijëve në Shqipëri**



**Pergatitur nga:**

**Alma MAKSUTAJ**

**dhe**

**ALTIN HAZIZAJ**

**Nentor 2005, Tirane**

## PERMBAJTJA

### FAQE

1) Përmbledhje e Përgjithshme	4
2) Koncepti i punës së fëmijëve dhe i fëmijëve të rrugës	6
3) Fenomeni punës së fëmijëve dhe i fëmijëve të rrugës në Shqipëri	9
4) Shkaqet e punës së fëmijëve në Shqipëri	12
5) Qëndrimi Social ndaj punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës	15
6) Legjislacioni ndërkombëtar dhe kombëtar për fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë	17
7) Pasojat e shfrytëzimit ekonomik mbi fëmijët	19
8) Rrethi vicioz i punës së fëmijëve dhe roli i institucioneve për eliminimin e fenomenit	22
9) Konkluzione dhe rekomandime	28
10) Bibliografia	31

### ANEKSET

▪ Raste Studimore të fëmijëve që punojnë	33
▪ Lista e personave të intervistuar	37

## LISTA E SHKURTIMEVE

- CRCA- Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri
- IRCCRA- Qendra e Informacionit dhe Kërkimeve për të Drejtat e Fëmijëve në Shqipëri
- OKB – Organizata e Kombeve të Bashkuara
- ILO- Organizata Ndërkombëtare e Punës
- UNICEF- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët
- IPEC- Programi Ndërkombëtar mbi Eleminimin e Punës së Fëmijëve
- OJF- Organizata Jo-fitimprurëse
- KDF- Konventa për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së

## FALENDERIME

Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri – CRCA, dëshirojnë të falenderojë për përgatitjen e këtij studim - raporti në mënyrë të veçantë:

- Znj. Alma Maksutaj dhe z. Altin Hazizaj për mbledhjen në kohë dhe analizimin e fakteve, dokumentave, të dhënave dhe intervistave, si dhe për përgatitjen e këtij Raporti.
- Olof Palme International Center, dhe SIDA Suedi, për mbështetjen financiare të programit të “Të Drejtat e Fëmijës janë të Drejta Demokratike”, si dhe për mbështetjen financiare në përgatitjen dhe botimin e këtij Raporti.
- Të gjithë përfaqësuesit e Qeverisë shqiptare dhe te organizatave jo-qeveritare, për ndihmën e jashtëzakonshme dhe informacionin e vënë në dispozicion.
- Të gjithë femijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës, të cilët folën hapur me ne rreth jetës, problemeve, frikës, dhe shqetësimeve të tyre.
- Stafin e Klubeve të Fëmijëve Kundër Punës së Fëmijëve në Tiranë, Kuçovë, Shkodër dhe Korçë për mbledhjen e informacionit në mënyrë profesionale dhe venien në dispozicion të rasteve studimore dhe të dhënave të tjera që janë përfshirë në këtë Raport.

## 1. PERMBLEDHJE E PERGJITHSHME

Ndryshimi i sistemit të qeverisjes, paqëndrueshmëria politike, ekonomike dhe sociale gjatë viteve '90 sollën në Shqipëri një periudhë tranzicioni të tejzgjatur, të shoqëruar me lindjen e një sërë fenomenesh negative. Një ndër këto fenomene është puna e fëmijëve dhe fëmijët e rrugës, si forma të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, të cilat përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Duke marrë në konsideratë këta faktorë, ndonëse gjatë viteve janë bërë shumë studime dhe janë zbatuar programe për eliminimin e punës së fëmijëve, me keqardhje mund të thuhet se situata nuk ka ndryshuar, madje mund të thuhet se ajo ka ardhur duke u përkeqësuar. Është fakt që çdo ditë shohim nëpër rrugë me qindra fëmijë që shesin, lypin, lajnë xhamat e makinave, ndërtojnë pallate, kujdesen për vëllezrit dhe motrat, apo për ekonominë e familjes së tyre. Kjo situatë e rëndë e shfrytëzimit të fëmijëve për qëllime ekonomike, është një ndër arsytet kryesore që shtynë Qendrën për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri – CRCA në përgatitjen e studimit “Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës në Shqipëri”.

Studimi “Puna e Fëmijëve dhe Fëmijët e Rrugës” është një studim cilësor. Në këtë studim janë pasqyruar konceptet bazë të asaj që konsiderohet puna e fëmijëve dhe fëmijët e rrugës, situatën e përgjithsme të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, shkakët që favorizojnë fenomenin, pasojat që sjell puna e fëmijëve të ndërthurura këto edhe me raste konkrete studimore. Në studim është pasqyruar gjithashtu çështja e fëmijëve të rrugës si dhe janë përpiluar një listë konkluzionesh dhe rekomandimesh, drejtuar aktorëve institucionale, që kanë për detyrë të marrin masa për eliminimin e çdo forme të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve.

Studimi ka përdorur një sërë metodash kërkimore si: intervistat e drejtpërdrejta me fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë, me përfaqësues të Qeverisë dhe OJF-ve në disa qytete të Shqipërisë; rishikimin e legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë, si dhe rishikimin e strategjive dhe politikave të Qeverisë shqiptare për fëmijët.

Ky studim nuk është realizuar pa ndeshur në një sërë vështirësish ndër të cilat mund të rendisim mungesën e të dhënave statistikore dhe gjithë-përfshirëse për numrin e fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës në Shqipëri; mungesën e informacionit më të fundit për familjet që jetojnë nën minimumin e varfërisë, si dhe mungesën e njohurive mbi fenomenin e punës së fëmijëve nga përfaqësues të nivelit të lartë apo të ulët të Qeverisë shqiptare.

Në Shqipëri mungojnë të dhënat për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës, ndërkohë që në vetëvetë fenomeni është evident dhe përbën një nga problemet më shqetësuese për fëmijët. Shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve përbëjnë një fenomen kompleks. Mungesa e sistemit të mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijës bën që fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës të kthehen në viktima të vepra penale si vjedhja apo shpërndarja e drogës dhe substancave të tjera të ndaluara me ligj.

Mungesa e sistemit të referimit dhe të shërbimeve të kualifikuara e bën të vështirë rehabilitimin e fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës. Shërbimet ekzistuese, ndonëse janë te pakta, ofrohen vetëm nga sektori i OJF-ve, ndërkohë që shërbimet shtetërore pothuajse nuk ekzistojnë.

Një ndër problemet më të cilat përballet sot Shqipëria është mungesa e legjislacionit të përshtatshëm për ndalimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve. Legjislacioni ekzistues nuk e konsideron si punë të fëmijës, punësimin e fëmijës nga familja, atë që në bazë të standarteve ndërkombëtare konsiderohet si punë në familje ose punë familjare. Mungesa e sanksioneve ndaj familjeve që shfrytëzojnë krahun e punës së fëmijës, qoftë në Kodin e Punës, ashtu edhe në Kodin Penal, bën që fëmijët shpesh të gjenden të pa mbrojtur nga ligji dhe

institucionet e zbatimit të ligjit. Studimi tregon se legjislacioni shqiptar nuk është në përputhje me standartet e kërkuara nga Konventa për të Drejtat e Fëmijës të OKB-së dhe konventave të ILO-s për punën e fëmijës.

Kodi i Punës nuk përmban ndonjë parashikim të veçantë lidhur me punën e detyruar të fëmijëve dhe të miturve. Kodi gjithashtu nuk përcakton kriteret e ndarjes në punë të lehtë dhe punë të rëndë të fëmijës. Ai gjithashtu nuk përcakton jo vetëm rregullat e punës familjare, por edhe një mbrojtje të veçantë për fëmijët që punojnë në familje. Legjislacioni nuk ka parashikuar struktura monitorimi për fëmijët që punojnë në sektorin informal. Ai ka parashikuar monitorimin dhe inspektimin nga Inspektoriati i Lartë i Punës të sektorin formal punëdhënës.

Qeveria shqiptare, gjatë këtyre 15 vjetëve ka treguar një mungesë të theksuar vëmendjeje për eliminimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe zhdukjes së shkaqeve që ndikojnë në egzistencën e punës së fëmijëve. Ndonëse bëhen afro pesëmbëdhjetë vjet që kur është shfaqur për herë të parë ky fenomen, shkaqet e punës së fëmijëve mbeten po të njëjtat. Mungesa e politikave qeveritare për fëmijët që punojnë ose për fëmijët e rrugës, mund të jetë një tregues i mungesës së dëshirës politike të Qeverisë për të ndërtuar një treg pune në Shqipëri, i cili respekton të drejtat bazë të fëmijës. Për aq kohë sa nuk punohet për zhdukjen e shkaqeve, shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve do të përbëjë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri.

Pasojat e përfshirjes së dhjetra-mijëra fëmijëve në punë në një moshë tepër të vogël dhe të papërshtatshme, nuk janë vetëm pasoja individuale por edhe kombëtare. Një nga rreziqet që çdo Qeveri do të përballet në të ardhmen e afërt, është mungesa e burimeve njerëzore-profesionale, të afta për t'u përballuar me tregun europian, pjesë e të cilit Shqipëria aspirojnë të bëhet. Mos-arsimimi i duhur i fëmijëve ka për ta bërë tepër të vështirë integrimin e tyre në tregun e punës shqiptar dhe europian. Si pasojë një pjesë e mirë e këtyre fëmijëve edhe kur të rriten do të kenë nevojë për ndihmën sociale dhe financiare të shtetit, që sigurisht duhet të mbulohet nga çdo taksapagues shqiptar.

Një pasojë tjetër e rëndë e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, është përfshirja e tyre në vepra penale apo grupe të organizuara të krimit. Puna e fëmijëve në rrugë, në mënyrë të natyrshme, ka krijuar një treg të shpërndarjes së mallrave në sasi të vogla. Sipas CRCA ekziston mundësia që ky treg të shfrytëzohet për shpërndarjen e lëndëve narkotike nga vetë fëmijët, të afërmit e tyre ose persona të tjerë të interesuar të shfrytëzojnë punën e fëmijëve. Ky rrezik sigurisht që mund të shmanget, vetëm me eliminimin e punës së fëmijëve.

Në anekset e këtij studimi janë përfshirë edhe një sërë rastesh studimore, të cilat janë trajtuar ndër vite, nga edukatorët dhe punonjësit sociale, të Klubeve të Fëmijëve Kundër Punës së Fëmijëve të CRCA. Pjesë e anekseve të studimit është bërë edhe lista e personave të intervistuar nga institucionet shtetërore dhe jo-qeveritare.

Sigurisht që ky studim nuk do të ishte bërë i mundur pa ndihmën dhe mbështetjen e Olof Palme International Centre dhe SIDA, organizata të cila mbështesin prej vitesh programin e studimeve dhe kërkimeve të CRCA, në fushën e të drejtave të fëmijëve.

## 2. KONCEPTI I PUNES SE FEMIJVE DHE I FEMIJEVE TE RRUGES

Në këtë studim, për shkak edhe të mungesës së përkufizimit dhe konceptit bazë në legjislacionin shqiptar, jemi përpjekur që të shpjegojmë konceptin e punës së fëmijës dhe të fëmijëve të rrugës, në bazë të konventave ndërkombëtare të OKB-së dhe ILO-s.

### 2.1 KONCEPTI I PUNES SE FEMIJES

Ndonëse ende nuk ka një përkufizim përfundimtar se çfarë do të konsiderohet punë e fëmijës apo fëmijë i rrugës, përsëri një sërë konventash apo organizatash ndërkombëtare janë munduar të japin një koncept të përshtatshëm të punës së fëmijës. Më poshtë kemi renditur disa nga këto koncepte dhe përkufizime.

#### a) Përkufizimi i Punës së Fëmijëve sipas KDF-së

##### Neni 32

1. Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për t'u mbrojtur nga shfrytëzimi ekonomik dhe nga kryerja e çdo pune që paraqet rreziqe ose që cënon edukimin e tij ose dëmton shëndetin apo zhvillimin e tij fizik, mendor, shpirtëror, moral ose shoqëror.
2. Shtetet Palë marrin masa legjislative, administrative, shoqërore dhe edukative, për të siguruar zbatimin e këtij neni. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve të tjera ndërkombëtare, Shtetet Palë në mënyrë të veçantë:
  - (a) Përcaktojnë një moshë minimale ose moshat minimale të pranimit në punë;
  - (b) Parashikojnë një rregullim të përshtatshëm të orarit të punës dhe të kushteve të punës;
  - (c) Japin dënime ose sanksione të tjera të përshtatshme për të siguruar zbatimin efektiv të këtij neni.

#### b) Përkufizimi i Punës së Fëmijëve sipas ILO-s

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) nuk ka një përkufizim të sajën përse i përket punës së fëmijëve dhe ia ka lënë vëndeve anëtare të saj të përcaktojnë se çfarë do të konsiderohet punë e fëmijës. Megjithatë ILO në dy konventa të saj, Konventën 138 dhe 182, sjell për herë të parë disa koncepte bazë të rëndësishme, që ndihmojnë në krijimin e një përkufizimi të punës së fëmijëve.

#### **Koncepti 1: “Fëmijë që punon” dhe “Fëmijë që ndihmon”**

Këto dy koncepte, që janë shumë të reja dhe të pandeshura në Shqipëri, përcaktojnë në një masë të madhe atë që mund të konsiderohet shfrytëzim i fëmijës ose punë e detyrueshme, krahasuar kjo me dëshirën e fëmijës për të ndihmuar familjen ose shoqërinë në një punë të caktuar. Koncepti “Fëmijë që punon” i referohet shfrytëzimit ekonomik të fëmijës (të detyruar dhe të rrezikshme), që përbën një punë të ndaluar për fëmijën dhe rrezikon mire-rritjen fizike, morale, emocionale dhe arsimore të tij. Ndërsa koncepti “fëmijë që ndihmon” i referohet çdo lloj pune që mund të kryejë fëmija në familje, shkollë, komunitet, por që nuk ka elementë të shfrytëzimit ose të rrezikut, të përshkruara më sipër.

Në këtë studim ne i jemi referuar vetëm termit “fëmijë që punon”, që në Gjuhën shqipe dhe në literaturën zyrtare gjerësisht gjendet nën termat “punë e fëmijës” ose “punë e fëmijëve”.

## **Koncepti 2: “Punë e lehtë” dhe “Punë e rrezikshme”**

ILO në Konventën 138 “Për Moshën Minimale të Pranimi në Punë” përcakton këto dy koncepte, të cilat kanë si qëllim që, nga njëra anë të ndalojnë punën e fëmijës nën një moshë të caktuar, por njëkohësisht të rregullojnë punën e fëmijës në moshën e lejuar dhe t’i mbrojnë ata nga çdo rrezik ose formë shfrytëzimi. Për këtë qëllim Konventa 138 e ILO-s kërkon nga shteti palë që të miratojë moshën minimale të pranimi të fëmijëve në punë, si dhe të përcaktojë format e punës së lehtë dhe të punës së rrezikshme për fëmijët.

ILO përcakton si “punë të lehtë” atë lloj pune, e cila nuk është e rrezikshme për shëndetin ose zhvillimin e fëmijës, dhe që nuk ndikon në vijueshmërinë e shkollës apo trainimit profesional. Për të përcaktuar nëse puna ka rrezik që të ndikojë negativisht tek fëmija, ILO, ndër shumë faktore të tjerë, merr në konsideratë kohëzgjatjen e punës, kushtet në të cilat ajo zhvillohet, efektet që ka mbi shkollimin e fëmijës.<sup>1</sup>

Ndërsa si “punë e rrezikshme” ILO përcakton çdo lloj pune, e cila nga natyra e saj dhe kushtet në të cilën zhvillohet, ka shumë mundësi që të rrezikojë shëndetin, sigurinë apo moralin e fëmijës.

## **Koncepti 3: “Punë e rëndë”<sup>2</sup>**

Konventa për Format më të Rënda të Punës së Fëmijës e ILO-s (No. 182) u adoptua zyrtarisht në vitin 1999 dhe deri më sot është ratifikuar nga 149 shtete, përfshirë edhe Shqipërinë<sup>3</sup>. Konventa 182 i kufizon akoma më tepër punët në të cilat mund të përfshihen. Gjithashtu ajo përcakton disa lloje pune, të cilat janë të ndaluara në mënyrë kategorike për fëmijët, si më poshtë:

- Të gjitha format e skllavërisë ose praktikave të ngjashme me të, si shitja dhe trafikimi i fëmijëve, punesimit për shkak të borxheve, si bujkrob ose punës së detyruar, përfshirë edhe rekrutimin në forcat e armatosura;
- Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për prostitucion, prodhimin e materialeve apo shfaqjeve pornografike;
- Përdorimin, prokurimin dhe ofrimin e fëmijës për aktivitete ilegale, në veçanti për prodhimin dhe trafikun e drogave (sipas përcaktimeve të standarteve ndërkombëtare mbi drogat);
- Puna, e cila nga natyra e saj ose kushtet në të cilat zhvillohet, ka mundësi që të rrezikojë shëndetin, sigurinë ose moralin e fëmijëve.

### **c) Koncepti i punës së fëmijës sipas CRCA**

Puna e fëmijës përfshin punën e paguar ose të papaguar, si dhe të gjitha aktivitetet që janë të rrezikshme dhe që ka mundësi të dëmtojë zhvillimin mendor, fizik, social, arsimor dhe moral të fëmijës.<sup>4</sup>

<sup>1</sup> <http://www.dol.gov/ilab/webmils/intllaborstandards/childlabor.html>

<sup>2</sup> Përkëthyer zyrtarisht në Shqip si “punë e keqe”

<sup>3</sup> Konventa për Format më të Rënda të Punës së Fëmijës u ratifikua nga Shqipëria në 2 Gusht 2001. Në fakt përkëthimi zyrtar i titullit të saj është Konventa për Format më të Këqia të Punës së Fëmijës.

<sup>4</sup> Manuali i Trainimit “Puna e Fëmijëve dhe Format më të rënda të saj” CRCA- ILO, Tiranë, Shtator 2001



## 2.2 PERKUFIZIMI I FEMIJES SE RRUGES

**Fëmijë të Rrugës ose fëmijë në rrugë janë ata fëmijë, të cilët jetojnë në rrugë, të cilët nuk kanë përkujdesje nga prindërit ose nga të rritur të tjerë dhe, të cilët flenë në rrugë sepse nuk kanë shtëpi.<sup>5</sup>**

Ndërkohë UNICEF<sup>6</sup>, si dhe një sërë studiuesish që janë marrë me këtë çështje, japin një përkufizim më të detajuar të fëmijës së rrugës, duke sjellë një sërë konceptesh të reja mbi këtë fenomen. Më poshtë janë përfshirë disa nga konceptet kryesore.

### **Koncepti 1: Fëmijë në rrugë**

- janë fëmijët që kanë kontakte të rregullta me familjen;
- shume prej tyre frekuentojnë shkollën;
- jane në rrugë që të sigurojnë të ardhurat që ju nevojiten për mbijetesën financiare të familjes;
- duan të largohen nga afmosfera shtypëse dhe mungesë hapsirës në shtëpi.

### **Koncepti 2: Fëmijë të Rrugës**

- janë fëmijët që kanë komunikim rastësor me familjen, ose vizitojnë rrallë shtëpinë e tyre;
- nuk frekuentojnë shkollën;
- largohen nga shtëpia drejt rrugës për shkak të dhunës në familjen e tyre, nga alkoolizimi i prinderve ose mungesa e kujdesit;
- shtëpia është një vënd i frikës dhe misterit;

### **Koncepti 3: Fëmijë që jetojnë në rrugë**

- jane fëmijët që nuk mbajnë kontakte me familjen ose janë pa familje;
- vlerësojnë rrugën si shtëpi të tyre, kërkojnë aty sigurinë dhe mbijetesën;
- krijojnë grupe ose banda me fëmijë të tjerë;
- jepen pas drogës;

**Koncepti 4: Fëmijë që jetojnë me familjen në rrugë,** do të konsiderohen të gjithë ata fëmijë që jetojnë me familjen e tyre në rrugë.

<sup>5</sup> [en.wikipedia.org/wiki/Street\\_children](http://en.wikipedia.org/wiki/Street_children)

<sup>6</sup> [www.house.gov/international\\_relations/109/sex091305.pdf](http://www.house.gov/international_relations/109/sex091305.pdf)

### 3. FENOMENI I PUNES SE FEMIJEVE DHE I FEMIJEVE TE RRUGES NE SHQIPERI

#### 3.1 TE DHENAT SASIORE DHE PUNA E FEMIJEVE

Në Shqipëri mungojnë të dhënat e besueshme për numrin e fëmijëve që punojnë dhe të fëmijëve të rrugës. Këto të dhëna bëhen akoma më pak të besueshme po të merret parasysh përkufizimi i cunguar që përdoret nga Inspektoriati i Lartë i Punës lidhur me punën e fëmijës, si dhe numri i fëmijëve që nuk janë të regjistruar në zyrat e gjendjes civile. Ky fakt na shtyn të besojmë se fenomeni i fëmijëve që punojnë dhe i fëmijëve të rrugës është në përmasa shumë herë më të mëdha, sesa ajo që njihet ose që është e dukshme.


INSTAT në studimin “Njerëzit dhe Puna në Shqipëri” të vitit 2004, raporton se 9.8 përqind e fëmijëve nga moshën 6-14-vjeç ishin të përfshirë në punë. Pjesa më e madhe e këtyre fëmijëve vijnë nga zonat rurale dhe punojnë në njësitë ekonomike-bujqësore, të drejtuara nga familjet e tyre.

Sipas INSTAT në zonat urbane punojnë vetëm 0.3 përqind e fëmijëve, ndërkohë që në zonat rurale janë të përfshirë vetëm 16 përqind e fëmijëve nga moshën 6-14 vjeç. Shumica e fëmijëve punojnë teksa vazhdojnë shkollën, ndërsa vetëm 8.9 përqind e tyre deklarojnë se nuk ndjekin shkollën. Të dhënat gjithashtu tregojnë se 2 përqind e fëmijëve që punojnë, janë të përfshirë në aktivitete tregëtare, ndërsa pjesa më e madhe, rreth 95.6 përqind e fëmijëve janë të përfshirë në aktivitete bujqësore <sup>7</sup>.

Sipas një studimi të CRCA<sup>8</sup>, përqindja e fëmijëve në Shqipëri është shumë herë më e lartë, sesa tregojnë shifrat në të vërtetë. Sipas studimit mëse 17 përqind e fëmijëve që ndjekin arsimin e detyrueshem deklarojnë se punojnë për të siguruar mbijetesën e tyre. CRCA mendon se mëse 50 mijë fëmijë në Shqipëri janë të përfshirë në punën e fëmijëve, përfshirë edhe fëmijët e rrugës.

#### 3.2 FORMAT E PUNES SE FEMIJEVE NE SHQIPERI

Puna e fëmijëve shfaqet në forma nga më të ndryshmet, të cilat përcaktohen nga tradita familjare, zona e banimit, situatë gjeografike e zonës ku punon fëmija etj. Një ndër pyetjet e pyetësorit të përdorur me përfaqësuesit e qeverisë dhe OJF-ve, ishte: Sipas të dhënave apo vëshgimeve tuaja, cilat janë format më të ndeshura të punës së fëmijëve në Shqipëri?



<sup>7</sup> Njerëzit dhe Puna, Krahu i Punës, Punësimi dhe Papunësia, INSTAT 2004

<sup>8</sup> “Rrethi Vicioz” – Studim i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri (CRCA, mbi shkaqet e braktisjes së shkollës nga fëmijët në Shqipëri, Tiranë 2000.

Në grafikun e paraqitur në këtë pjesë të studimit tregohen format më të ndeshura të punës së fëmijëve në Shqipëri, bazuar në përgjigjet e të intervistuarve.

Sipas përgjigjeve të dhëna nga të intervistuarit përfaqësues të institucioneve qeveritare, institucioneve joqeveritare si dhe fëmijëve që punojnë, fëmijë që janë në risk për punë dhe fëmijë të tjerë, ka dalë së forma më e ndeshur e punës së fëmijëve në Shqipëri është shitja ambulatore.

Pas formës së shitjes vjen lypja, puna në ndërtim, puna e vajzave në rrobaqepsi, shfrytëzimi për qëllime prostitucioni dhe shfaqje pornografike etj. Formë tjetër e punës së fëmijëve e ndeshur në Shqipëri po sipas përgjigjeve të të intervistuarve, është peshkimi, sidomos për fëmijët që vinë nga zonat bregdetare.

Puna në bujqësi është një nga format më të ndeshura të punës së fëmijëve. Forma e punës më pak e ndeshur, sipas të intervistuarve, është përfshirja e fëmijëve në shpërndarje droge.

Të intervistuarit mendojnë se një formë tjetër pune pak e ndeshur është puna e fëmijëve në shtëpi. Arsyeja është se puna në shtëpi është më e fshehur dhe zhvillohet në mjedis të mbyllura. Kjo lloj pune ndeshet sidomos tek fëmijët-vajza.

### 3.3 KATEGORITE E PUNES SE FEMIJES

Për të qenë sa më objektiv, jemi munduar që të bëjmë një ndarje në kategori të fëmijëve që punojnë, bazuar edhe në karakteristikat e tregut të punës, ose formave që ky treg paraqet. Dy kategoritë kryesore që mund të përmendim janë:

**1. Fëmijët që punojnë në sektorin formal të ekonomisë,** si në rrobaqepsi, fabrikat e prodhimit të këpucëve, në ndërtim etj. Këta fëmijë janë kryesisht nga mosha 14-18 vjeç. Puna e fëmijëve në sektorin formal parimisht është e kontrollueshme nga Inspektoriati i Përgjithshëm i Punës, por realisht ndodh që fëmijët të manipulojnë moshën e tyre për të bërë të mundur hyrjen e tyre në raport pune, për të ndihmuar familjet e tyre, ose në rastet kur Kodi i Punës nuk zbatohet nga punëdhënësi.

**2. Fëmijët që punojnë në sektorin joformal të ekonomisë,** janë fëmijë që kryesisht punojnë në rrugë si: shitës ambulantë, lypsa, pastrues të makinave në semaforë, shpërndajnë drogë, etj, ose fëmijë që punojnë në bujqësi. Puna e këtyre fëmijëve nuk kontrollohet nga Inspektoriati i Lartë i Punës, për shkak sepse mandati i tij përfshin punën vetëm në sektorin formal. Si rrjedhim puna e fëmijëve në sektorin joformal

## FORMAT ME TE RENDA TE PUNES SE FEMIJEVE

- 1. Format e skllaverise dhe praktikat e ngjashme me të**
  - Shitja e fëmijëve;
  - Trafikimi i fëmijëve;
  - Bujkrobëria;
  - Puna pa dëshirë ose e detyruar;
  - Rekrutimi pa dëshirë ose i detyruar në konflikte të armatosura;
- 2. Përdorimi, gjetja ose dhënia e një fëmije për:**
  - shfaqje pornografie;
  - prostitucion, prodhim pornografie;
- 3. Përdorimi, gjetja ose dhënia e një fëmije për:**
  - veprimtari të paligjshme;
  - trafikimi i drogave;
- 4. Puna që rrezikon shëndetin, sigurinë, moralin e fëmijëve:**
  - punë që ekspozojnë fëmijët ndaj abuzimit fizik, emocional ose seksual;
  - punë nëntokë, nën ujë, lartësi të rrezikshme, në hapësira të kufizuara;
  - punë me makineri, me pajisje dhe me vegla të rrezikshme;
  - punë që përfshin përpunimin ose transportin fizik të ngarkesave të rënda;
  - punë në një mjedis të pashëndetshëm, i cili mund të ekspozojë fëmijët ndaj lëndëve, faktorëve ose proceseve të rrezikshme, ose ndaj temperaturave, niveleve të zhurmave ose dridhjeve të rrezikshme, që dëmtojnë shëndetin e tyre;
  - punë me orë të zgjatura ose gjatë natës ose puna që nuk lejon kthimin në shtëpi çdo ditë, ose puna në të cilën fëmija është i mbyllur në mënyrë të paarsyshme në vëndin e punës;

mbetet e pakontrolluar dhe e pambikqyrur. Gjithashtu karakteristikë e punës në këtë sektor është fakti se një numër i konsiderueshëm i këtyre fëmijëve nuk janë të rregjistruar në gjendjen civile.

### 3.4 FAZAT E PUNES SE FEMIJEVE

- a) **Fillimi i punës.** Këtë moment fëmijët mund ta përjetojnë në formën e një ndryshimi domethënës të botës së tyre sociale. Për disa fëmijë ky proces mund të shfaqet në mënyrë më graduale. Në këtë fazë fokusi kryesor i fëmijës mund të përfshijë mënyrën si trajtohet nga punëdhënësit dhe reagimi i tij ndaj kësaj eksperience përfshin tregues të stresit në rritje ose të jetës stresuese.
- b) **Jeta në punë.** Në këtë moment fëmija mund të ketë muaj ose vite që punon dhe zakonisht është mësuar me pritshmëritë e punëdhënësve, me praktikën e punës dhe aftësitë që i duhen. Disa fëmijë mund të kenë provuar lloje të ndryshme pune, ndoshta edhe njëkohësisht. Indikatorët në këtë moment bazohen në vëzhgime të vendit të punës si dhe në marrëdhëniet e tij me punëdhënësit, ose ndjenjat e fëmijës mbi aspekte të ndryshme të punës.
- c) **Përfundimi i fëmijërisë.** Në këtë moment fëmija mund të ketë filluar një punë tjetër, mund të ketë ndërprerë marrëdhëniet e punës, ose mund të jenë ende në të njëjtën punë, por jo më si fëmijë. Fokusi kryesor në këtë pikë do ishte në indikatorët e mirëqënies psiko-sociale të të riut, reflektimi i tyre mbi eksperiencën e punës që në fëmijëri dhe ideja e lidhjes së tyre me situatën aktuale dhe atë të ardhshme.

### 3.5 KUSHTET NE TE CILAT PUNOJNE FEMIJET

Kushtet në të cilat punojnë fëmijët, janë një pikë shumë e rëndësishme për t'u analizuar. Fëmijët e punësuar në sektorin joformal punojnë në kushte shumë të rënda dhe shpesh të rrezikshme. Një pjesë e mirë e fëmijëve e kalojnë gjithë ditën në kushte atmosferike të pafavorshme, në temperatura të ulta apo të larta, punojnë në vende ku ka lëvizje të shpeshta të makinave ose mjeteve të tjera të transportit.

Këta fëmijë punojnë me kohë të pacaktuar, sepse shpesh rrezikohen të bëhen viktimat e dhunës fizike, nëse nuk kanë siguruar një shumë të caktuar të ardhurash ditore.

Fëmijët që punojnë në sektorin formal, ndonëse duket se punojnë në kushte më të favorshme, ata punojnë në vende ku rrezikohet seriozisht shëndeti i tyre, për shkak të makinerive ose kontaktit me lëndë të rrezikshme.

Sipas Inspektoriatit të Lartë të Punës “ndodh shpesh që punëdhënësit nuk zbatojnë kushtet e punës, të parashikuara në Kodin e Punës.”

#### KODI I PUNES

**Në nenin 78/3 parashikohet se për punëmarrësit nën moshën 18 vjeç, kohëzgjatja ditore në punë duhet të jetë jo më shumë se 6 orë në ditë. Çdo 7- ditë, të miturit nën 18 vjeç, kanë të drejtë të përfitojnë një periudhë pushimi prej 2 ditësh vijuese, përfshirë dhe të dielën.**

**Në rast se të miturit nën 18 vjeç punojnë më gjatë se katër orë e gjysëm në ditë, ata kanë të drejtë të përfitojnë një periudhë pushimi prej 30 minutash çdo ditë. Pushimi ditor për të miturit është të paktën 11 orë pa ndërprerje brenda ditës ose në rast nevojë për dy ditë rresht.**

## 4. SHKAQET E PUNES SE FËMIJËVE

Shkaqet e punës së fëmijëve dhe të fëmijëve të rrugës janë një kombinim i disa faktorëve që krijojnë një terren të përshtatshëm për shfaqjen dhe zhvillimin e këtij fenomeni.

Nëse do të analizonim shkaqet e fenomenit të punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës ndër vite, vihet re se shkaqet thuhet mbeten të njëjta, por në to ka ndryshuar vetëm niveli i tyre. Nëse marrim në konsideratë varfërinë, si një ndër shkaqet kryesore të punës së fëmijëve, ndonëse ajo ka ardhur duke ulur, për shkak të rritjes së prodhimit të përgjithshëm bruto, ajo nuk është eliminuar dhe vazhdon të përbëjë një problem shqetësues për shumë familje.

Duke studiuar fenomenin mund të themi se fëmijët punojnë për arsye të ndryshme, por arsyeja kryesore mbeten të ardhurat që ata krijojnë në ekonominë familjare. Në këtë studim ne jemi përpjekur që shkaqet e punës së fëmijëve t'i ndajmë në tre grupe. Në këtë kapitull do të trajtojmë shkaqet ekonomike, ndërsa më poshtë do të trajtojmë faktorët familjarë dhe ata shoqërorë.

### 4.1 SHKAQET EKONOMIKE

#### a) Varfëria ekstreme

Banka Botërore vlerëson se rreth 150 mijë individë në Shqipëri jetojnë në kushtet e varfërisë ekstreme, ose rreth 5 përqind e popullsisë në vend<sup>9</sup>. Sipas vlerësimit ky grup e ka të pamundur që të plotësojë edhe nevojat më bazë për ushqim.

Varfëria ekstreme është një nga arsyet kryesore të punës së fëmijëve. Kjo varfëri lidhet me vendin ku jeton fëmija, por dhe me familjen e tij. Rrethanat mund të kërkojnë që fëmijët të kontribuojnë në ekonominë e familjes, kur ajo përballet me sigurimin e mbijetesës dhe mundësi të kufizuara punësim të të rriturve. Problemet e veçanta me të cilat përballen këto familje mund t'i detyrojnë fëmijët të kërkojnë dhe të kryejnë punë që nuk janë në fushën e traditës së tyre, në mënyrë që të sigurojnë mbijetesën e familjes. “Më pëlqen të shkoj në shkollë, por më duhet të laj xhamat e makinave, sepse përndryshe mami nuk ka se çfarë të na japë për të ngrënë” thotë E.L. Fëmijët e familjeve të divorcuara; fëmijët që jetojnë në jetimore dhe fëmijët e prindërve me aftësi të kufizuara mund të jenë nën një presion të jashtëzakonshëm për tu punësuar.

---

<sup>9</sup> Banka Botërore, Raport No. 26213-AL, Shqipëria: Vlerësimi i Varfërisë ([http://www-wds.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/WDSP/IB/2003/12/16/000012009\\_20031216103618/Rendered/PDF/262130AL.pdf](http://www-wds.worldbank.org/servlet/WDSContentServer/WDSP/IB/2003/12/16/000012009_20031216103618/Rendered/PDF/262130AL.pdf))

## b) Papunësia

Ndryshimi i sistemit mbylli mjaft aktivitete ekonomike dhe rriti numrin e të papunëve, të moshës së aftë për punë. Niveli i papunësisë në fund të vitit 1992 ishte 26 përqind, që tregon se ai u rrit 3 herë krahasuar me vitin 1991.

Sipas INSTAT treguesit e papunësisë në shkallë vendi për vitin 2000 janë 16.8 përqind ndërsa për vitin 2002 rreth 15.8 përqind. Ndonëse në dukje paradoksale, papunësia e të rriturve ekziston përkrah me punësimin e fëmijëve dhe sipas bindjes sonë përbën një nga faktorët nxitës të punësimit të fëmijëve. Tregu i punës ofron mundësi të ndryshme për të rriturit krahasuar me fëmijët.<sup>10</sup>

**Tabela 3.9 - Popullsia sipas gjinisë, vendodhjes dhe statusit ekonomik: 2002 LSMS**

Gjinia/Zona	Shkalla bruto e punësimit	Shkalla e papunësisë		Shkalla e aktivitetit	
		Definicioni standart	Definicioni i zgjeruar	Definicioni standart	Definicioni i zgjeruar
<b>Meshkuj</b>					
Tirana urbane	52.2	18.9	24	64.4	68.7
Të tjera urbane	48.3	19.8	26.8	60.6	66.4
Rurale	65.6	4.3	7.2	78.5	80.9
Vendi	58.5	10.1	14.5	71.2	74.9
<b>Femra</b>					
Tirana urbane	26.4	22.2	29.8	33.9	37.6
Të tjera urbane	26.1	28.3	40.7	37.2	45.1
Rurale	46.9	2	6.7	59.1	62
Vendi	38	9.9	17.5	49.3	53.8
<b>Gjithsej</b>					
Tirana urbane	38.8	20.1	26.2	48.5	52.5
Të tjera urbane	36.6	23.3	32.8	48.3	55.1
Rurale	55.7	3.3	6.9	68.2	70.9
Vendi	47.7	10	15.8	59.6	63.8

Burimi: përpunimi i të dhënave LSMS 2002.  
<sup>(a)</sup> konsiderohen të papunë ata që punojnë në bujqësi për më pak se 15orë/javë

Papunësia kontribuon në krijimin e varfërisë dhe ajo përbën një dukuri shqetësuese, që ka shoqëruar shoqërinë shqiptare gjatë viteve të tranzicionit. Papunësia është e lidhur ngushtë me mundësitë që ofron tregu i punës si dhe me mundësitë e kufizuara që ka familja për të siguruar ushqim, veshje, strehim dhe nevoja të tjera bazë materiale dhe shpirtërore për anëtarët e saj.

## c) Niveli i pagave dhe kosto e jetesës

Pagat në Shqipëri janë ndër më të ultat në Europë, ndërkohë që kostoja e jetesës ka ardhur duke u rritur. Një studim i Bankës Botërore, mbi situatën e varfërisë në Shqipëri, tregon se rreth 25 përqind e popullësisë në Shqipëri ose afërsisht 780,000 individë jetojnë nën minimumin e pranuar të varfërisë. Katër në pesë të varfër banojnë në zonat rurale dhe niveli i të ardhurave ndryshon sipas rretheve. Varfëria monetare është më e lartë në ato familje ku kryefamiljari ka nivel të ulët arsimor.<sup>11</sup>

Varfëria ka një ndikim jo-proporcional tek fëmijët - rreth 40 përqind e familjeve me tre ose më shumë fëmijë janë të varfëra, krahasuar me 25 përqind të numrit të përgjithshëm të familjeve në Shqipëri.

<sup>10</sup> Njerëzit dhe Puna, Krahu i Punës, Punësimi dhe Papunësia, INSTAT 2004

<sup>11</sup> Banka Botërore, Strategjia e Asistencës për Shqipërinë 2003-2005.

#### d) Tregu i punës

Tregu i punës ofron vende pune në katër sektorë kryesorë: tregti, shërbime, transport dhe ndërtim. Pjesa më e madhe e punëdhënësve janë biznesmenë të vegjël ose të mesëm, dhe aktiviteti i tyre përfshin: servis makinash, transport, pika karburanti, ndërtim, shërbime komunale, shitje malli me shumicë dhe pakicë. Një pjesë e punëdhënësve nuk kanë liçence për ushtrim aktiviteti dhe kanë një sërë problemesh që lidhen me detyrimet ndaj shtetit.

Nga vlerësimi rezulton se janë katër arsye kryesore të punësimit të fëmijëve nga punëdhënësit: a) dëshira e punëdhënësve për t'i ndihmuar ekonomikisht fëmijët dhe familjet e tyre, b) ndihma për të marrë një zanat nëpërmjet punës; c) përfitimi ekonomik dhe menaxhimi më i lehtë i fëmijëve; d) lidhja familjare, miqësore ose e fqinjësisë. Puna e fëmijëve është më e lehtë për ta menaxhuar, pasi fëmijët janë më pak të vetëdijshëm për të drejtat e tyre, krijojnë më pak shqetësime, ankohen më pak, janë më fleksibël dhe paguhen më pak, për shkak të moshës së tyre.

#### e) Mungesa e Infrastrukturës

Dukë qenë se Shqipëria është një shtet i varfër, ajo ka mungesa të dukshme të infrastrukturës. Në zonat rurale mungojnë rrugët e përshtatshme për të shkuar në shkollë ose shkollat gjenden në kushte të vështira. Mungesa e infrastrukturës së duhur shkollore dhe kushteve të përshtatshme i shtyn fëmijët drejt largimit nga shkolla.

Sipas Bankes Botërore, varfëria monetare bëhet më e theksuar si rezultat i infrastrukturës dhe shërbimeve të dobta apo i mungesës së tyre në të gjithë vëndin. Rreth 40 përqind e familjeve nuk sigurojnë dy ose më shumë shërbime bazë si: arsimimin 9- vjeçar, furnizimin me ujë dhe ngrohjen.

#### Intervistë me A. T. 9 vjeç, Tiranë

**Pse nuk shkon në shkollë?**

**AT. Në fshatin tonë nu ka shkollë, shkolla është larg.**

**Me çfarë merresh gjatë ditës?**

**AT. Shkoj punoj tek shtëpia e dokoreshës së fshatit.**

**Çfarë pune bën atje?**

**AT. Fshij, laj shtëpinë, laj enët, hekuros, i mbaj dhe një vajzë të vogël deri sa ajo vjen nga puna.**

**Sa orë në ditë punon ?**

**AT. Unë punoj nga ora 7.30 e mëngjësit në orën 6 pasdite.**

**Sa paguhesh në ditë?**

**AT. Ajo më jep 300 lekë (të reja), por më jep dhe drekë dhe ndonjëhere dhe rroba për të veshur.**

## 5. QENDRIMI SOCIAL NDAJ PUNES SE FEMIJEVE DHE FEMIJEVE TE RRUGES

### 5.1 FAKTORET FAMILJARE

#### a) Familjet jo-funksionale

Numri i familjeve me një prind po vjen duke u rritur çdo vit në Shqipëri. Numri i madh i divorceve dhe largimi i prindërve jashtë shtetit janë disa nga arsyt e këtij fenomeni. Dhuna në familje dëmton mirëqënien e familjes. Situatat që krijohen në një familje jo-funksionale e vendosin fëmijën në një pozitë tepër të vështirë.

Për familjet me probleme, shkollimi i fëmijës nuk është prioritet kryesor. Edhe nëse fëmija e ndjek shkollën ai / ajo ka një mbikqyrje të vogël nga prindërit. Në këto familje, sistemi mbështetës ndaj fëmijës, kthehet në një sistem që ka nevojën për ndihmën e tij. Mbi fëmijën fillon të bjerë përgjegjësia për të kontribuar ekonomikisht në familje.

Kjo situatë e vështirëson funksionimin normal të familjes. Si rrjedhojë prindërit apo të afër të tjerë të fëmijës kthehen në shfrytëzues të fëmijës. Shpesh fëmijët e rrugës ose fëmijët që punojnë, të pyetur se çfarë bëjnë me të ardhurat që krijojnë nga puna, përgjigjen: “i merr mami” ose “ajo nuk më jep asnjë lekë as për të blerë hamburger, kur me merr uria” ose “kur fitoj pak lek më rreh se mendon se i kam prishur ose m’i kanë vjedhur lekët fëmijët e tjerë, ose se unë jam i pazotë në punë.”

#### b) Profili i fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës

Në këtë studim ne jemi përpjekur që të paraqesim edhe një profil të drejtë të fëmijëve që punojnë dhe të fëmijëve të rrugës. Ky profil bazohet në të dhënat e mbledhura ndër vite nga puna në Klubet e Fëmijëve, dhe nga marrja në konsideratë e karakteristikave familjare dhe sociale që paraqet çdo fëmijë.

Në përgjithësi mund të themi se fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës janë fëmijë me probleme familjare, që jetojnë në kushte të vështira ekonomike dhe një pjesë e tyre janë pa prindër ose vetëm me një prind. Në shumicën e rasteve fëmijët nuk shkojnë në shkollë ose mungojnë shpesh në shkollë dhe një pjesë të madhe të kohës e kalojnë në rrugë.

Një fakt, që është bërë edhe më shumë evident gjatë viteve të fundit, është se një pjesë e mirë e fëmijëve që shesin në rrugë janë fëmijë, të cilët vijnë nga familje që kanë migruar nga zonat rurale në ato urbane.

Fëmijët marrin përgjegjësi të parakohshme mbi supet e tyre dhe shpesh është puna e tyre që mban me të ardhura familjen e tyre. Për këtë shkak ata e kanë të nevojshme që ndonjëherë të punojnë bashkë me prindërit e tyre, kërkojnë të kenë pavarësi ekonomike;

#### Profili i prindërve dhe i shfrytëzuesve të punës së fëmijës

- Janë prindër ose të afërm të fëmijës;
- Janë prindër me të ardhura të pakta familjare;
- Janë vëllai ose motra e madhe, që ka bërë të njejtën gjë në moshë më të vogël;
- Janë persona tek të cilët fëmijët janë shitur nga prindërit ose të afërmit e tyre;
- Janë persona të njohur të familjes, tek të cilët familja ka besim;
- Janë prindër ose të afërm të fëmijës të cilët jetojnë në rrugë;
- Janë prindër që janë shfrytëzuar vetë, kur kanë qenë fëmijë;
- Janë prindër pa bashkëshort ose bashkëshorte;
- Janë anëtarë grupesh ose bandash kriminale;



Ndërkohë përse i përket fëmijëve të rrugës, në bazë edhe të praktikës së rregjistruar deri më sot, shumë prej tyre nuk ju pëlqen shkolla, sepse nuk janë të mësuar me rregullat. Për shkak se janë edhe fëmijë të neglizhuar, kanë probleme të përqëndrimit në mësim. Fëmijët e rrugës në një moshë më të madhe i gjen shpesh të shoqëruar me fëmijë të tjerë ose me të rritur, qoftë edhe në formën e organizuar të grupeve ose bandave, që në disa raste shfrytëzohen nga të rritur të tjerë për vjedhje ose grabitje. Një karakteristike e përgjithshme thuhet e të gjithë fëmijëve që punojnë dhe atyre të rrugës është se ata i tërheqin eksperiencat e reja ose aventurat.

## 5.2 FAKTORET SOCIAL

### a) Qëndrimi ndaj disa minoriteteve

Në Shqipëri, si në shumë vende të tjera, komuniteti Rrom jo gjithmonë shihet pozitivisht nga një pjesë e popullsisë. Shumë fëmijë Rromë thonë se ata nuk ndjehen të respektuar në shkollë dhe ndodh shpesh që mësuesit i caktojnë të ulen në fund të klasës, ose ata bëhen subjekt i talljeve të nxënësve jo-Rrom. Ndonëse mungojnë të dhënat bazë, është pranuar fakti që një familje Rrome përmban një numër më të madh fëmijësh sesa familjet jo-Rrome. Të ardhurat e pakëta dhe kultura ku fëmija konsiderohet “i rritur” që në adoleshencë, përbëjnë një shtrat favorizues të përfshirjes së fëmijëve në punë që në moshë të vogël, nga ky komunitet.

### b) Normat kulturore

Studiuesit besojnë se punësimi i fëmijëve nuk do të ishte kaq i përhapur, nëse nuk do të ishte i pranueshëm nga ana sociale dhe kulturore. Disa nga faktorët socialë dhe kulturorë të cilët favorizojnë punën e fëmijëve janë:

- Mendimi se çdo lloj pune është e mirë për formimin e karakterit dhe zhvillimin e aftësive tek fëmijët;
- Tradita, sipas së cilës, fëmijët duhet të ndjekin gjurmët e prindërve të tyre, në një zanat të caktuar, dhe të mësojnë ta praktikojnë këtë zanat që në një moshë të vogël;
- Fenomeni i kontributit nga të gjithë pjestarët e familjes për larjen e borxheve, ku përfshihen edhe fëmijët (në ndonjë rast kryefamiljari kanë hyrë në borxh sepse ka luajtur bixhoz dhe fëmija është detyruar të punojë për të paguar borxhet që ka i ati);
- Stereotipi se vajzave nuk iu nevojitet arsim më shumë se djemve, çon në angazhimin e vajzave me punë në shtëpi ose në punësimin familjar të tyre;
- Stereotipi se shkolla nuk paraqet më interes për fëmijët;
- Mentaliteti i prindërve që jetojnë në rrugë (nëse unë jetoj në rrugë dhe ti do të jetosh në rrugë);
- Mungesa e cilësisë dhe përshtatshmërisë së arsimit, me nevojat që ka familja;

## 6. LEGJISLACIONI NDERKOMBETAR DHE KOMBETAR PER FEMIJET E RRUGES DHE FEMIJET QE PUNOJNE

### 6.1 STANDARTET NDERKOMBETARE PER PUNEN E FEMIJES<sup>12</sup>

**Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut.** Kjo konventë është ratifikuar nga Qeveria Shqiptare më 4 Nëntor 1995, ligji nr 8137, datë 31.07.1996, Fletore Zyrtare nr 20 Gusht 1996). Në nenin 4, Konveta ndalon punën pa dëshirë dhe atë të detyrueshme.

**Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike.** Adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, me 16 Dhjetor 1966 (ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr. 7510, datë 08.08.1991, Fletore Zyrtare Nr.6, Gusht 1991). Në nenin 24 thuhet se “Të gjithë fëmijët pa diskriminim race, ngjyre, seksi, gjuhe, feje, origjinës kombëtare ose sociale, pasurie apo lindjeje, kanë të drejtë të përfitojnë, nga ana familjes së tyre, shoqërisë edhe shtetit, masa mbrojtëse që kërkon moshën e tyre e mitur”.

**Pakti Ndërkombëtar Mbi të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore.** Ky pakt është adoptuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 16 Dhjetor 1966, ratifikuar nga Shqipëria në Gusht 1991. Pakti vendos detyrimin për shtetet ratifikuese të marrjes së masave mbrojtëse speciale për fëmijët dhe adoleshentët. Fëmijët dhe adoleshentët duhet të mbrohen nga shfrytëzimi ekonomik dhe shoqëror. Në nenin 10, kërkohet që Shtetet të përcaktojnë moshën limit nën të cilët puna e fëmijëve është e ndaluar.

**Karta Sociale Europiane.** Ratifikuar nga Shqipëria me Ligjin Nr.8960, datë 24.10.2002 (Fletore Zyrtare Nr. 75, Dhjetor 2002). Karta Sociale Europiane vendos veçanerisht këto detyrime për shtete anëtare:

- të përcaktohet moshën minimale 15 vjeç, si moshën minimale për punë;
- të ndalohet puna e fëmijëve gjatë periudhës së shkollës;
- të kufizohet kohëzgjatja e punës për personat nën moshën 16 vjeç;
- të vendoset që kohëzgjatja e pushimeve të paguara për personat nën 18 vjeç është 3 javë;
- të ndalohet puna e natës për personat nën 18 vjeç;
- të vendoset kontrolli i detyruar tek mjeku për personat nën moshën 18 vjeç, të cilët punësohen në vende pune të përcaktuara nga ligji.

**Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës.** KDF-ja u adoptua nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, më 20 Nëntor 1989, dhe është ratifikuar nga Shqipëria në vitin Shkurt 1992. Shtetet palë të kësaj konvente njohin të drejtën e arsimit bazë, të detyrueshëm dhe pa pagesë për të gjithë fëmijët, si dhe mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë shfrytëzimi.

**Konventa e ILO-s Nr. 138, Për moshën minimale të pranimit në punë.** Shteti shqiptar e ka ratifikuar këtë Konventë në vitin 1999. Shtetet që ratifikojnë Konventën Nr. 138 të ILO-s duhet të marrin një sërë masash për të sigurruar ndalimin e punës së fëmijëve dhe të rrisin progresivisht moshën minimale për punësimin e fëmijëve në përshtatje me zhvillimin fizik dhe mendor të fëmijës.

**Konventa e ILO-s Nr. 182 Për Format më të rënda të punës së fëmijëve.** Ratifikuar nga Shqipëria më datë 23.04.2001, kjo konventë përcakton format më të rënda të punës së fëmijëve (shih Kapitullin Fomat e Punës së Fëmijëve). Çdo shtet ratifikues të kësaj konvente duhet të marrë një sërë masash për të ndaluar çdo lloj forme të rëndë të punës së fëmijëve.

<sup>12</sup> Puna e Fëmijëve dhe Legjislacioni Shqiptar, studim i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Tiranë, Korrik 2005

## 6.2 LEGJISLACIONI SHQIPTAR DHE PUNA E FEMIJEVE

**Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.** Në themel të legjislacionit shqiptar qëndron Kushtetuta. Nenit 54 i Kushtetutës parashikon një mbrojtje të veçantë të fëmijëve nga Shteti. Gjithashtu ajo parashikon të drejtën e çdo fëmije për të qënë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë veçanërisht nën moshën minimale për punë të fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën ose zhvillimin tij normal.

**Kodi i Punës.** Kodi i punës, në Nenin 11 të tij, parashikon se të drejtat dhe detyrimet lidhur me marrëdhëniet e punës rregullohen nga Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë. Si rrjedhim Konventat e ratifikuara nga Shqipëria mund të zbatohen në mënyrë të drejtpërdrejtë, nëse nuk kërkojnë nxjerrjen e një ligji të posaçëm.<sup>13</sup>

Kodi i Punës trajton çështjet e punësimit nëpërmjet dispozitave të veçanta si ndalimin e punës së detyrueshme, detyrimin e punëdhënësit të respektojë punëmarrësin përfshirë këtu dhe kujdesin për shëndetin. Kodi i Punës nuk ka ndonjë parashikim të veçantë lidhur me punën e detyrueshme të të miturve. Në nenin 98, Kodi i Punës përcakton moshën 16-vjeç si moshën minimale të pranimit në punë. Ky përcaktim është në përputhje me Konventën Nr. 138 të ILO-s. Gjithashtu në Kodin e Punës lejohet puna e fëmijëve ndërmjet moshës 14-16 vjeç, vetëm në punë të lehtë dhe në periudhën e pushimeve shkollore.

Kodi i Punës përcakton se fusha e veprimtarisë së tij nuk shtrihet mbi familjen. Punët familjare që mund të kryhen nga bashkëshorti, bashkëshortja ose fëmijët, përfshihen në nenin 5/c të tij. Por Kodi nuk parashikohen rregullat e punës familjare si dhe sigurimin e mbrojtjes së fëmijëve që punojnë. Për sa i përket punës në shtëpi në nenin 15 të Kodit të Punës parashikohet se, punëmarrësi që punon në shtëpi, gëzon të njëjtat të drejta si dhe punëmarrësi që punon në një sipërmarrje. Përsëri këtu nuk është përmendur mbrojtja e veçantë në rastet kur fëmijët punojnë në shtëpi.

## 6.3 POLITIKAT QEVERITARE PER FEMIJET E RRUGES DHE FEMIJET QE PUNOJNE

**Strategjia Kombëtare për Fëmijët 2005-2010.** Strategjia Kombëtare për Fëmijët në Shqipëri, u miratua nga Këshilli i Ministrave me Vendim Nr. 368, Date 31.05.2005, dhe përbën një përpjekje serioze të Qeverisë shqiptare. Pjesë e rregullimeve që propozon Strategjia është edhe fenomeni i punës dhe trafikut të fëmijëve. Në këtë Strategji dhe në Planin e Veprimit janë parashikuar një sërë masash që Qeveria shqiptare do të ndërmarrë për të eliminuar në mënyrë progresive punën e fëmijëve, përfshirë edhe trafikun e fëmijëve. Ndër masat kryesore që mund të përmendim është supervizimi më i mirë i tregut formal të punës, si dhe forcimi i arsimimit, si një element progresiv kundër punës së fëmijëve.

**Strategjia Kombëtare në Luftë Kundër Trafikut të Fëmijëve në Shqipëri 2005-2007.** Strategjia Kombëtare në Luftë Kundër Trafikut të Fëmijëve është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 11.02.2005. Strategjia ka si qëllim përsheptimin e nismave të ndërmarrë për të minimizuar dhe eliminuar fenomenin e trafikut të fëmijëve në Shqipëri, si një nga format më të rënda të punës së fëmijëve. Në këtë strategji dhe në planin e saj të veprimit janë parashikuar masa në lidhje me braktisjen e shkollës, punën e fëmijëve, uljen e varfërisë si dhe janë parashikuar alternativat për të zgjidhur këto probleme.

<sup>13</sup> Puna e Fëmijëve dhe Legjislacioni Shqiptar, studim i Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Tiranë, Korrik 2005

## 7. PASOJAT E SHFRYTËZIMIT EKONOMIK MBI FEMIJET

### 7.1 PASOJAT INDIVIDUALE

#### a) Pasoja fizike dhe seksuale<sup>14</sup>

Me pasoja fizike do të kuptojmë pasojat që sjellin tek fëmijët kushtet e mjedisit, tejlohdhja, sëmundjet, ulja e rezistencës, pamjaftueshmëria në ushqyerje, rrezatimet, lëndet toksike, të cilat mund të shkaktojnë sëmundje të ndryshme tek fëmija ose në zhvillimin e tij të mëvonshëm.

- **Aksidentet.** Tek fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës aksidentet janë shpeshta dhe me rrezikshmëri të lartë për jetën e tyre, deri me pasojë edhe vdekjen. Këto lloj aksidentesh varen nga faktorë të ndryshëm. Në këto aksidente mund të përfshijmë rëniet nga lartësitë, prerjen e gishtave apo të gjymtyrëve, shëmbjen e minierave dhe puseve, goditjet me mjetet e forta në organe të ndryshme etj. Po këtu klasifikohen edhe aksidentet automobilistike, ku më të rrezikuar nga këto dëmtime janë fëmijët e rrugës.
- **Helmimet.** Helmimet janë më të ndeshura tek puna e fëmijëve në industri, në fabrika këpucësh, fabrika farmaceutike apo detergjentësh, ose ndërmarrje të vogla që përdorin substance kimike gjatë procesit të punës. Helmimet paraqesin tek fëmijët rrezikshmëri të lartë në organet e frymëmarrjes, pjesë të ndryshme të trupit, apo edhe invaliditetin e përhershëm ose vdekjen e fëmijës.
- **Djegjet.** Djegjet e fëmijëve nga lëndë të ndryshme të rrezikshme, lëndë alkaline ose acid, shkaktojnë dëmtime të parikthyeshme në organizmin e fëmijëve. Djegjet mund të jenë të brendshme ose të jashtme.
- **Dhuna fizike dhe seksuale,** raportohet nga shumë fëmijë që punojnë në rrugë, si shitës ambulantë dhe si lypës. Shpesh fëmijët bëhen pre e dhunës së të rriturve, kur këta të fundit nuk kanë lek të paguajnë, ose kërkojnë të vjedhin nga fëmijët ose nëpërmjet fëmijëve. Nga ana tjetër fëmijët e rrugës, edhe për shkak se qëndrojnë dhe flenë jashtë, gjithmonë ndodhen nën rrezikun e ngacimit ose abuzimit seksual, si nga fëmijë të tjerë të rrugës, ashtu edhe nga të rriturit.
- **Vrasja.** Vrasjet e fëmijëve mund të ndodhin nga abuzuesit, nga persona me prirje kriminale ose pedofilët. Këto vrasje mund të jenë si pasojë e përfshirjes së fëmijës në veprimtari kriminale, ose për shkak të abuzimit seksual të fëmijës.

#### b) Pasoja emocionale dhe psikologjike

- **Çrregullimet e sjelljes.** Si pasojë e punës që bëjnë fëmijët kanë deficite të arsimimit dhe edukimit të tyre. Ata, duke punuar në rrugë, zhvillojnë sjellje të rrugës apo sjellje të tjera që nuk i praktikojnë fëmijët e tjerë që janë në kontakt më shkollën. Sjelljet e tyre verbale shoqërohen me fjalor të papërshtatshëm për moshën e tyre. Karakteristikë në sjelljen e fëmijët që punojnë është se ata sillen si të rritur.

<sup>14</sup> Manuali i Trainimit “Puna e Fëmijëve dhe Format më të rënda të saj” CRCA- ILO, Tiranë, Shtator 2001

- **Çrregullime emocionale.** Fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës ndjehen emocionalisht ndryshe nga fëmijët e tjerë. Ata e ndjejnë që nevojat e tyre nuk janë plotësuar si psh. nevoja për dashuri, argëtim etj. Këtyre fëmijëve nuk iu është kushtuar vëmendje dhe nuk i ka pyetur njeri sesi ndihen për punën që bëjnë. Emocionet e fëmijëve që punojnë nuk janë të zhvilluara. Ata nuk janë mësuar të shprehin emocionet e tyre. Fëmijët që punojnë karakterizohen nga një fëmijëri jo e lumtur.
- **Stresi post-traumatik (PTSD)** është një sindromë që përfitohet nga abuzimi, traumat, dëmtimi personalitetit dhe moralit të të fëmijës. PTSD nuk është një sëmundje, por një kompleks shenjash që e torturojnë fëmijën. Fëmija është i traumatizuar nga ngjarja dhe e shfaq atë me çrregullime të gjumit, të ushqyerjes, apo të sjelljes. Shpesh ka raste kur fëmijët kryejnë vetë-vrasje nga dëshperimi. Shpesh këta fëmijë jetojnë në kushtet e një depresioni familjar dhe përjetojnë rëndë depresionin e prindërve, të cilët kanë humbur punën dhe mjedisin social. Ky lloj depresioni ndodh më shpesh tek kryefamiljarët, të cilët nuk janë të aftë të mbajnë dot familjen. Në këtë situatë fëmija më i madh (që në përgjithësi është djalë) merr përsipër rolin e babait.
- **Koncepti për veten.** Koncepti për veten tek fëmijët që punojnë varet dhe nga puna që këta fëmijë bëjnë. Nëse fëmijët punojnë në ndërtim ata ndihen se janë rritur parakohe dhe mund të bëjnë punë të mëdha dhe mund të sigurojnë të ardhura të mira. Gjithashtu këta fëmijë që mund të bëjnë punë të mëdha përpara bashkëmoshatarëve të tyre ndihen inferior. Kjo ndjenjë inferioritete i djek ata për gjithë jetën.
- **Stanjacioni (qëndrimi në vënd) apo kthimi prapa.** Nëse do të shikojmë zhvillimin e fëmijëve që punojnë ta nuk i kalojnë të gjitha fazat e zhvillimit të njeriut. Ata ose i kapërcejnë ato ose qëndrojnë në vënd dhe nuk zhvillohen. Personaliteti i fëmijës që punon pëson çrregullime. Ai rrezikon të bëhet një qenie njerëzore e rritur para kohe ose mund të mbetet gjithmonë fëmijë me nevoja të paplotësuara. Këta fëmijë duke mos kaluar të gjitha fazat e zhvillimit humbasin një pjesë të jetës së tyre sidomos fëmijërinë e tyre.
- **Shëndeti psikologjik.** Fëmijët që punojnë nuk janë të shëndetshëm nga ana psikologjike. Ata janë të prirur për të vuajtur nga ankthi, pagjumësia, depresioni ose iu shfaqen sëmundje të shëndetit mendor. Depresioni është një nga format më të ndeshura të mungesës së shëndetit psikologjik tek fëmijët që punojnë. Fëmijët që punojnë nuk e shohin jetën me optimizëm. Ata e shohin se edhe pse punojnë gjithë ditën gjendja e tyre financiare mbetet e keqe. Ata përjetojnë faktin se rezultatet e mundit të tyre nuk i përfitojnë ata, por shfrytëzuesit e tyre dhe nga ky fakt ata ndjehen të zhgënjyer. Pasojë e punës së fëmijëve janë dhe dëmtimet psikike. Fëmijët që punojnë janë të rrezikuar nga sëmundje të shëndetit mendor si p.sh. depresioni madhor, çrregullime personaliteti, anoreksia, bulimia ose ankthi.

## 7.2 PASOJAT PER FAMILJEN

Siç e kemi paraqitur më sipër në këtë studim, pasojat i punës së fëmijëve nuk janë vetëm individuale, por dhe familjare. Tek pasojat familjare mund të veçojmë dy lloj pasojash: sociale dhe ekonomike.

### a) Pasojat Sociale

- Familja vazhdon të mos rrisë nivelin e saj arsimor;
- Familja mbetet e përfshirë nga probleme sociale;
- Familja mund të përfshihet në veprimtari kriminale;
- Familja krijon viktime të shfrytëzimit seksual apo ekonomik;

**b) Pasojat Ekonomike**

- Ndonëse puna e fëmijëve përmirëson përkohësisht gjëndjen ekonomike të familjes, për shkak të paaftësisë së integritit në tregun e punës, ajo mbetet gjithmonë e rrezikuar nga ana ekonomike;
- Familja jeton nën riskun që të mbetet gjithmonë e varfër;
- Familja vazhdon të riciklojë varfërinë gjeneratë pas gjenerate;

**7.3 PASOJAT PER SHOQERINE DHE VENDIN**

**a) Pasojat Sociale dhe politike**


- Fëmijet e rrugës, fëmijët që punojnë dhe familjet e tyre, kërkojnë në vazhdueshmëri asistencën e shërbimeve sociale;
- Rrezikojnë të mbeten të përjashtuar nga ana sociale, të paintegruar në shoqëri, gjë që rrit vulnerabilitetin e tyre;
- Shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve ndikon në uljen e nivelit arsimor të shoqërisë dhe të vendit;
- Ndikon në uljen e nivelin social-kulturor të vendit;
- Ndikon në zhvillimin e kriminalitetit dhe krimin të organizuar;

**b) Pasojat Ekonomike**

- Shfrytëzimi ekonomik i fëmijëve ndikon në mos zhvillimin e ekonomisë së vendit, për shkak të papërshtatshmërisë arsimore me tregun e punës dhe pamundësisë së integritit në këtë treg;
- Mungesa e arsimimit të duhur, kërkon nga Qeveria shpenzime të vazhdueshme për mbajtjen e tyre me ndihmë sociale dhe financiare, ose për arsimimin e tyre profesional në të ardhmen;
- Kontribuon shumë pak në rritjen ekonomike të vendit, si në të tashmen ashtu edhe në të ardhmen, duke ulur fuqinë blerëse të shoqërisë;
- Nuk forcon situatën financiare të familjes, përkundrazi e varfëron atë më tej. Për shkak të mungesës së sigurimit social, fëmijët dhe familjet e tyre nuk gëzojnë përfitimin e një pensioni në pleqëri, duke u kthyer kështu në konsumues të fondeve publike gjatë gjithë jetës së tyre;
- Një pjesë e madhe e fëmijëve që rriten duke punuar ose si fëmijë të rrugës, gjatë gjithë jetës së tyre kanë nevojë për ndihmën financiare të shtetit për të siguruar mbijetesën e tyre, fonde të cilat mund të shpenzoheshin në drejtim të fuqizimit të arsimimit ose shërbimit shëndetësor për të gjithë taksapaguesit.

## 8. RRETHI VICIOZ I PUNES SE FEMIJES DHE ROLI I INSTITUCIONEVE PER ELEMINIMIN E FENOMENIT

### 8.1 SKEMA E RRETHIT VICIOZ TE PUNES SE FEMIJEVE DHE FEMIJEVE TE RRUGES



Më sipër studiuesit, në bazë të të dhënave dhe vëzhgimeve që i kanë bërë fenomenit të punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës, janë përpjekur që të paraqesin një skemë të thjeshtë, për të bërë të mundur shpjegimin e fenomenit. Këtë skemë ne e kemi quajtur me të drejtë ‘Rrethi Vicioz’ për shkak sepse ai përsërit vetveten<sup>15</sup>. Qëllimi i kësaj skeme është të paraqesë në mënyrë skematike sesi përsëritet fenomeni i punës së fëmijëve nga njëri brez në tjetrin.

Në kutinë ‘Prindi’ paraqitet situata e një individi, i cili ka krijuar familje, por nuk ka mundësi për të plotësuar nevojat e kësaj familje. Familja nën presionin e kushteve të vështira ekonomike dhe sociale angazhon fëmijën e saj në punë. Duke u angazhuar në punë, fëmija nuk ka mundësi të ndjekë procesin mësimor dhe si rrjedhojë largohet nga shkolla. Fëmija mbetet pa marrë arsimimin e duhur, punon gjithë ditën, paguhet pak dhe të ardhurat e tij janë të pamjaftueshme për të plotësuar nevojat e të gjithë familjes.

Ky fëmijë, pasi rritet, krijon familjen e tij / saj, ndonjëherë edhe në moshë shumë të re. Fëmija tashmë është bërë prind (kutia ‘Prindi 1’). Situata e familjes së re ka shumë probabilitet që të jetë e njëjtë me kushtet në të cilat jetonte prindi i fëmijës, që tashmë është bërë prind vetë.

Prindi paguhet pak dhe nuk arrin të plotësojë nevojat e familjes së tij. Shkak për këtë bëhet mungesa e arsimimit të duhur, pamundësia për të gjetur një punë më të paguar dhe modelit të krijuar që në fëmijërinë e tij, se fëmija është një krah pune dhe ndihme për familjen. Në këtë situatë Prindi 1, punëson fëmijën e tij në të njëjtën lloj pune ose profesioni, që ai/ajo ka bërë kur ishte fëmijë. Fëmija i këtij prindi (shih kutinë ‘Fëmija 1’) duke qënë se rritet në kushte të vështira, tek ai ndikojnë të njëjtët faktorët ekonomikë, social dhe kulturorë, që kanë ndikuar tek prindi i tij, të cilët nuk e lënë të dalë nga kjo gjendje.

<sup>15</sup> “Rrethi Vicioz” quhet edhe studimi i parë që Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve – CRCA, ka realizuar mbi fenomenin e punës së fëmijëve në Shqipëri dhe pasojat e saj mbi fëmijën. “Rrethi Vicioz” u botua nga CRCA për herë të parë në vitin 2000.


E gjithë situata përsërit vetveten dhe kërkohen një sërë faktorësh që mund të thyejnë rrethin vicioz. Kjo skemë është vërtetuar në praktikë, sidomos në rastet e fëmijëve dhe familjeve që lypin, por edhe në shumë raste të fëmijëve që punojnë.

### **Si mund të thyejmë Rrethin Vicioz?**

- **Duke zbatuar strategji për eliminimin e varfërisë;**
- **Duke përpiluar dhe zbatuar politika të nxitjes së punësimit për shtresa të veçanta të shoqërisë;**
- **Duke përmirësuar dhe fuqizuar sistemin arsimor, nëpërmjet rritjes së buxhetit për arsimin;**
- **Duke ofruar kurse të trainimit profesional për fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë;**
- **Duke ofruar shërbime për fëmijët dhe familjet;**
- **Duke eliminuar shkaqet që çojnë në favorizimin e fenomenit të punës së fëmijëve;**
- **Duke ndërgjegjësuar opinionin publik, familjet dhe fëmijët që punojnë, për pasojat që sjell puna e fëmijëve;**
- **Duke zbatuar programe gjithë-përfshirëse, me të gjithë aktorët që ndikojnë në eliminimin e punës së fëmijëve, përfshirë edhe viktimat e shfrytëzimit ekonomik dhe familjet e tyre;**
- **Duke përmirësuar legjislacionin kombëtar dhe duke e përafëruar atë me standartet ndërkombëtare.**



## 8.2 SISTEM I REFERIMIT DHE ROLI I INSTITUCIONEVE PER ELEMINIMIN E SHFRYTEZIMIT EKONOMIK TE FEMIJEVE



### a) Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka një sërë detyrimesh karshi fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës. Për këtë qëllim pranë kësaj Ministrie është ngritur dhe funksionon prej disa vitesh Njësia Kundër Punës së Fëmijëve. Roli i Njesisë mund të përshkruhet si më poshtë:

- Ngritjen e një kuadri institucional për zbatimin e programeve kombëtare të eliminimit të punës së fëmijëve,
- Rritjen e kapaciteteve dhe trainimin e inspektorëve të punës, për të trajtuar efektivisht dhe monitoruar çështjen e punës së fëmijëve,
- Rritjen e ndërgjegjesimit publik për fenomenin e punës së fëmijëve dhe përparandalimin progresiv të tij,
- Rishikimin e kuadrit ligjor mbi punën e fëmijëve për harmonizimin e tij me standartet ndërkombëtare.

### b) Inspektoriati i Lartë i Punës

Inspektoriati i Lartë i Punës është një strukturë qendrore që funksionin pranë Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta. Detyrat e Inspektoriatit përcaktohen gjithashtu edhe në Kodin e Punës. Roli i këtij inspektoriati për punën e fëmijëve është:

- Të kontrollojë dhe monitorojë punën formale të fëmijëve në ndërmarrje shtetërore ose private,
- Të kontrollojë kushtete e punës së fëmijëve,
- Të gjobisë ose marrë masa të tjera, deri në heqjen e licenses, kompanive private që punësojnë fëmijë nën moshën e përcaktuar me ligj ose që nuk u ofrojnë kushte të përshatshme pune për ta, sipas Kodit të Punës.

### **c) Policia e Shtetit**

Policia e Shtetit dhe Komisarariatet e Policisë kujdesen për fëmijën që punon, në momentin kur fëmija apo një person tjetër denoncon shfrytëzimin ekonomik të fëmijës. Mungesa e një sistemi të mbledhjes të të dhënave nga Policia e Shtetit, e bën thuajse të pamundur studimin e rolit që luan Policia në mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht.

Roli kryesor i policisë dhe punonjësve të saj është marrja në mbrojtje dhe kujdes e fëmijës së shfrytëzuar, hapja e procedurave penale për dhunuesin, gjetja e një avokati ose punonjësi social për fëmijën, si dhe referimi i fëmijës në një institucion të specializuar si shërbimi shëndetësor, ai social ose pranë OJF-ve. Megjithatë, meqënëse mungon infrastruktura e mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijës, dhe për shkak të respektimit të procedurave, shpeshherë policia gjendet përballë faktit që është e detyruar ta dërgojë fëmijën në familjen shfrytëzuese.

Nga ana tjetër ka një mungëse të plotë të lidhjeve institucionale që duhet të egzistojnë midis policisë dhe shërbimit social. Punonjësi i policisë lihet i vetëm përballë fëmijës, duke mos patur në dispozicion asnjë lloj procedure ose manuali ndihmës, që mund t'i tregojë se kë duhet të kontaktojë dhe si duhet të silllet me fëmijën.

### **d) Shërbimet shëndetësore**

Shërbimi shëndetësor ka për detyrë të kujdeset për mbrojtjen e shëndetit të fëmijës dhe promovimin e një jetese të shëndetshme fizike, mendore dhe seksuale. Megjithatë, ndonëse puna e fëmijëve përbën një problem shqetësues për shoqërinë, ende në sistemin shëndetësor mungojnë specialistët dhe infrastruktura e trajtimit, kujdesit dhe rehabilitimit për fëmijën e shfrytëzuar.

Nga ana tjetër është detyrë e shërbimit shëndetësor që të bëjë edhe verifikimin e formës dhe pasojave të punës së fëmijëve, qoftë kjo fizike, seksuale ose emocionale. Faktet e mbledhura dhe të çertifikuara nga mjeku përkatës janë ato që shërbejnë dhe merren në cilësinë e provës nga trupi gjykues, prokuroria ose policia, në rastet kur çështja i referohet sistemit të drejtësisë.

### **e) Shërbimi social**

Ndonëse bëhet kohë që administrata e shërbimit social është krijuar në Shqipëri, ende ajo vazhdon të mbetet më shumë një dhënësi i ndihmës ekonomike, sesa një ofrues shërbimi në komunitet në ndihmë të personave në nevojë. Pranë Shërbimit Social në nivel lokal, ka një mungesë të theksuar të një strukture që të jetë përgjegjëse për fëmijët (me përjashtim të Bashkisë së Tiranës), ndonëse ligji kërkon ndërhyrjen në rastet e fëmijëve të shfrytëzuar ekonomikisht.

Ndonëse Shërbimi Social është institucion shtetëror drejtëpërsëdrejti përgjegjës për monitorimin dhe ndjekjen e rasteve të fëmijëve që punojnë apo fëmijëve në rrugë, deri më sot nuk ka patur asnjë rast të zbuluar, ndjekur ose referuar nga ky institucion. Kjo tregon për mangësitë në burime njerëzore, financiare dhe në infrastrukturë të Shërbimit Social, i cili është ende larg të qenit afër komunitetit. Ky shërbim është gjithashtu përgjegjës për krijimin e sistemit të referimit dhe menaxhimit të rastit, duke bërë pjesë të mandatit të tij, punën me policinë, shkollat, shërbimin shëndetësor, familjen, OJF-të etj.

## **f) Pushteti Vendor**

Pushteti Vendor mund të luajë një rol vendimtar në eliminimin e punës së fëmijës. Për shkak edhe të paqartësive që ekzistojnë në procesin e decentralizimit, shumë përfaqësues të pushtetit vendor ende nuk kanë një tablo të qartë për rolin që mund të luajnë Bashkitë dhe Komunitet në këtë drejtim. Në bazë të ligjit të ri të shërbimit social, menaxhimi i shërbimeve sociale ka kaluar në varësi të pushtetit lokal, ndërkohë që Administrata e Përgjithshme e Shërbimit Social është përgjegjëse vetëm për inspektimin e kushteve në të cilat ofrohen këto shërbime nga pushteti lokal.

Më poshtë jemi munduar që të bëjmë një liste të shkurtër të përgjegjësive që ka pushteti lokal për eliminimin e fenomenit të punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës:

- Të bëjë vlerësimin e situatës së fenomenit të punës së fëmijëve në nivel bashkiak ose komunal;
- Të ofrojë shërbime të përshtatshme sociale për fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë;
- Të koordinojë shërbimet që ofrohen për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës;
- Të ndikojnë në shpërndarjen e drejtë të shërbimeve që ofrohen nga OJF-të lokale dhe kombëtare për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës;
- Të zbatojë masat ndëshkimore për prindërit shfrytëzues së fëmijëve të tyre;
- Të kontraktojë shërbimet e OJF-ve ose ato të ofruara nga institucione të tjera private;

## **g) Shkolla**

Shkolla, e parë si një sistem më vete, duhet të luajë një rol të padiskutueshëm në evidentimin e rasteve të fëmijëve të punojnë dhe sidomos të fëmijëve që janë në risk për punë. Meqë fëmija qëndron për një periudhë relativisht të gjatë në shkollë, mësuesit janë ndër të parët që ndeshin pasojat e punës së fëmijëve. Shume rrallë ka ndodhur që rastet e fëmijëve të referohen tek punonjësit socialë ose psikologët në shkolla. Nëse trupa mësimore në sistemin arsimor merr trainimin e duhur, ajo mund të ndihmojë për mbrojtjen e fëmijëve nga dhe identifikimin e rasteve të riskut. Roli i mësuesit nuk është të trajtojë rastet e fëmijëve që punojnë, por vetëm të referojë të gjitha rastet e ndryshimta tek personi i specializuar, dhe të ndikojë në përmirësimin e sistemit arsimor për të qënë një shkollë më miqësore për fëmijët.

## **h) Sistemi i drejtësisë**

Sistemi i drejtësisë është përgjegjës, jo vetëm për dhënien e drejtësisë dhe dënimin e dhunuesve të fëmijës, por njëkohësisht edhe krijimin e kushteve të përshtatshme për marrjen e dëshmisë së fëmijës, dëgjimin e opinionit të fëmijës, si dhe kompensimin e fëmijës për dëmin që i është shkaktuar. Studimi i rolit të sistemit të drejtësisë dhe rasteve të gjyqimit bëhet tepër i vështirë për shkak të mungesës të të dhënave. Nga ana tjetër mungesa e një gjykate të specializuar për çështjet e fëmijëve, bën që trajtimi dhe gjykimi i rasteve të fëmijëve të bëhet nga gjykatës të paspecializuar në fushën e të drejtave të fëmijëve. Sistemi i drejtësisë ka nevojë të ndryshojë qëndrimin e tij ndaj fëmijës, duke krijuar mjedise dhe procedura të posaçme për një trajtim sa më miqësor të fëmijës.

### **i) OJF-të**

Sigurisht që OJF-të kanë një rol të rëndësishëm në sensibilizimin e shoqërisë dhe Qeverisë (në nivel qendror dhe lokal) për pasojat e e punës së fëmijëve. Nga ana tjetër nuk mund të mohohet roli që shoqëria civile mund të luajë duke krijuar modele të shërbimeve të suksesshme si në parandalimin, tërheqjen e fëmijëve nga vendi i punës, rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri.

### **j) Komuniteti**

Komuniteti ka një rol të padiskutueshëm në evidentimin dhe raportimin e rasteve pranë institucioneve përgjegjëse. Çdo lloj shfrytëzimi ndaj fëmijës përbën një krim jo vetëm ndaj individit, por edhe shoqërisë. Komuniteti është prezent, sheh dhe vëzhgon raste të ndryshme jo vetëm të shfrytëzimit të fëmijëve të ushtruara nga prindërit, por edhe sjelljen e fëmijëve, e cila ndonjëherë mund të duket e çuditshme ose nuk paraqitet si normale. Sot egzistojnë mundësi për komunitetin që të raportojë pranë Policisë ose Shërbimit Social raste të shfrytëzimit të fëmijëve dhe të ndihmojë në kalimin e rasteve në të gjitha hallkat e sistemit të referimit.

## 9. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

### 9.1 KONKLUZIONET E RAPORTIT

- Puna e fëmijëve dhe fëmijët e rrugës, si forma të shfrytëzimit ekonomik dhe punës së detyruar të fëmijëve në Shqipëri, përbëjnë një nga shkeljet më të rënda të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, dhe ato zhvillohen në kundërshtim të hapur me legjislacionin kombëtar dhe standartet ndërkombëtare të OKB-së dhe ILO's.
- Situata e shfrytëzimit ekonomik të punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës, nuk ka ndryshuar, madje mund të thuhet se ajo po vjen duke u përkeqësuar, për shkak të mungesës së sanksioneve civile dhe penale ndaj të gjithë atyre që shfrytëzojnë punën e fëmijëve. Legjislacioni ekzistues nuk e konsideron si shfrytëzim ekonomik të fëmijës, shfrytëzimin që i bën punës së fëmijës, familja e tij.
- Fenomeni i punës së fëmijëve dhe i fëmijëve të rrugës, ka lidhje të drejtëpërdrejtë me krimin e trafikimit të fëmijëve. Nje pjesë e madhe e fëmijëve që punojnë deklarojnë se kanë dëshirë të largohen nga Shqipëria për të punuar në vendet perëndimore. Fakti që puna e fëmijëve zhvillohet më së shumti në rrugë, i bën fëmijët një grup tepër vulnerabël për t'u rrëmbyer dhe trafikuar. Nga ana tjetër një pjesë e fëmijëve që punojnë, dhe sidomos e fëmijëve të rrugës, deklarojnë se janë viktima të trafikimit në vendet perëndimore. Kjo tregon edhe një here se këta fëmijë janë kontigjenti më i rrezikuar për t'u përdorur për trafikim të brendshëm dhe ndërkombëtar.
- Sipas statistikave zyrtare mesë 9.8 përqind e fëmijëve të moshës 6-14 vjeç në Shqipëri shfrytëzohen ekonomikisht, ndërsa sipas një studimi të CRCA, mëse 50 mijë fëmijë në Shqipëri janë përfshirë në fenomenin e punës së fëmijëve dhe fëmijëve të rrugës. Megjithatë sistemi i mbledhjes të të dhënave për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës është i vjetër, dhe si pasojë, të dhënat nuk ndihmojnë dot Qeverinë për të bërë një analizë të drejtë të situatës, si dhe për përgatitjen e politikave të përshtatshme për këtë grup shoqëror.
- Qeveria shqiptare, gjatë këtyre 15 vjetëve ka treguar një mungesë të theksuar vëmendjeje për eliminimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve dhe zhdukjes së shkaqeve që ndikojnë në egzistencën e punës së fëmijëve. Mungesa e politikave qeveritare për fëmijët që punojnë ose për fëmijët e rrugës, mund të jetë një tregues i mungesës së dëshirës politike të Qeverisë për të ndërtuar një treg pune, i cili respekton të drejtat bazë të fëmijës.
- Prindërit e fëmijës, janë njëkohësisht edhe shfrytëzuesit e fëmijës. Mungesa e një ligji të përshtatshëm për ndalimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijës, rrezikon që ta kthejë punë e fëmijëve në një krim akoma më të rrezikshëm sesa trafikimi i fëmijëve, sepse ai shtrihet në një territor më të gjerë dhe nuk është i dënueshëm.
- Varfëria ekstreme, kultura familjare dhe mungesa e një sistemi të fortë arsimimi, janë ndër faktorët kryesorë që nxisin punën e fëmijëve. Megjithatë nuk mungojnë rastet kur prindërit ose persona të tjerë, shfrytëzojnë ekonomikisht fëmijën, për shkak të kontrollit që mund të ushtrojnë mbi të, si dhe të përfitimit më të madh që mund të sigurojnë nga puna e lirë e fëmijës.
- Mungesa e sistemit të mbrojtjes dhe kujdesit ndaj fëmijës, sistemit të referimit dhe shërbimeve të kualifikuara e bën të vështirë rehabilitimin e fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës.

- Mungesa e sanksioneve ndaj familjeve që shfrytëzojnë krahun e punës së fëmijës, qoftë në Kodin e Punës, Kodin e Familjes dhe në Kodin Penal, bën që fëmijët të gjenden të pa mbrojtur nga ligji dhe institucionet e zbatimit të ligjit.
- Pasojat e përfshirjes së dhjetra-mijëra fëmijëve në punë në një moshë tepër të vogël dhe të papërshtatshme, nuk janë vetëm pasoja individuale por edhe kombëtare. Një nga rreziqet që çdo Qeveri do të përballet në të ardhem e afërt, është mungesa e burimeve njerezor profesionale, të afta për t'u përballuar me tregun europian, pjesë e të cilit Shqipëria aspiron të bëhet. Mos-arsimimi i duhur i fëmijëve ka për ta bërë tepër të vështirë integrimin e tyre në tregun e punës shqiptar dhe atë europian. Si pasojë një pjesë e mirë e këtyre fëmijëve edhe kur të rriten do të kenë nevojë për ndihmën sociale dhe financiare të shtetit, kosto të cilat duhet të mbulohen nga çdo taksapagues shqiptar.
- Nje pasojë tjetër e rëndë e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve, është përfshirja e tyre në vepra penale apo grupe të organizuara të krimit. Puna e fëmijëve në rrugë, në mënyrë të natyrshme, ka krijuar një treg të shpërndarjes së mallrave në sasi të vogla. Ekziston një mundësi reale që ky treg të shfrytëzohet për shpërndarjen e lëndëve narkotike nga vetë fëmijët, të afërmit e tyre ose persona të tjerë të interesuar të shfrytëzojnë punën e fëmijëve. Ky rrezik sigurisht që mund të shmanget, vetëm me eliminimin e punës së fëmijëve.

## 9.2 REKOMANDIMET

### Për Parlamentin shqiptar

- ④ Të miratojë ndryshime legjislative në Kodin e Punës, Kodin Penal dhe Kodin e Familjes, për të mbrojtur fëmijët nga çdo formë e shfrytëzimit ekonomik, pavarësisht se kush është shfrytëzuesi i fëmijës;
- ④ Të përpilojë dhe miratohet një ligj për të drejtat e fëmijëve në Shqipëri;
- ④ Të kërkojë shtesa në buxhetin e shtetit për shërbimet për fëmijët që punojnë apo fëmijët e rrugës, përfshirë edhe arsimimin e tyre.

### Për Qeverinë shqiptare

- ④ Të nxisë përmirësimin legjislativ në Kodin e Punës, Kodin Penal dhe Kodin e Familjes, për të bërë të mundur mbrojtjen e fëmijëve nga çdo formë e shfrytëzimit ekonomik;
- ④ Të marrë masa për të bërë të mundur përfshirjen në arsimin të detyrueshëm të çdo fëmije në Shqipëri;
- ④ Të rrisë buxhetin për arsimin dhe ndihmën sociale, përfshirë këtu edhe krijimin e mundësive për të rritur ndihmën ekonomike për fëmijët e varfër që ndjekin shkollën.

### Për Ministrinë e Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

- ④ Të marrë masa për përmirësimin e legjislacionit kombëtar në përputhje me standartet ndërkombëtare të punës së fëmijëve;

- ④ Të forcojë Inspektoriatin e Lartë të Punës, për të bërë të mundur kontrollin e duhur dhe vendosjen e sanksioneve ndaj të gjitha bizneseve që shfrytëzojnë ekonomikisht fëmijët, sidomos në industrinë e lehtë, atë të turizmit dhe të ndërtimit.

### **Për Ministrinë e Brëndëshme**

- ④ Të ofrojë mbrojtje të përshtatshme dhe procedura të shpejta të ndjekjes dhe referimit të të gjitha rasteve të shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve;
- ④ Të përpilojë dhe të miratojë Kodin e Sjelljes së punonjësit të policisë me fëmijët;

### **Për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës**

- ④ Të nxisë Qeverinë për rritjen e buxhetit për arsimin dhe të marrë masa për përmirësimin fizik të kushtet të shkollave, sidomos në zonat rurale;
- ④ Të rishikojë Ligjin ‘Për Sistemin Arsimor Para-universitar’ dhe të propozojë krijimin e mekanizmave të rinj që bëjnë të mundur zbatimin e ligjit.
- ④ Të sigurojë një arsim bashkohor dhe me standarte të përshtatshme për fëmijët në shkollë;
- ④ Të shohë mundësinë e krijimit të menceve të shkollës, qoftë nëpërmjet partneritetit publik-privat, të cilat mund të ofrojnë ushqim falas për fëmijët e varfër dhe ata në risk për të braktisur shkollën.
- ④ Të shohë mundësinë e hapjes së klasave kundër analfabetizmit, ku të afrojë të gjithë fëmijët, pavarësisht nga mosha ose gjendja e tyre.

### **Për Ministrinë e Drejtësisë**

- ④ Të marrë masa për përmirësimin e Kodit të Familjes dhe Kodit Penal për të bërë të mundur dënimin e shfrytëzimit ekonomik të fëmijëve;

### **Për Pushtetin Lokal (Bashkitë dhe Komunat)**

- ④ Të marrin masa për hapjen e Zyrave për të Drejtat e Fëmijës në çdo Bashki dhe Komunë, si zyra të ofrimit të shërbimeve sociale për fëmijëve;
- ④ Të krijojnë sisteme të referimit të rastit, duke përfshirë të gjithë aktorët qeveritarë dhe joqeveritarë;
- ④ Të ofrojë shërbime të përshtatshme për fëmijët që punojnë dhe fëmijët e rrugës;

### **Për OJF-të**

- ④ Të ofrojnë shërbime në fushën e parandalimit, rehabilitimit dhe ri-integrimit të fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës;
- ④ T’i bëjnë presion qeverisë shqiptare dhe institucioneve të saj për të marrë masa për të përmirësuar situatën e fëmijëve që punojnë dhe fëmijëve të rrugës;
- ④ Të ndërgjegjësojnë opinionin publik mbi pasojat e shfrytëzimit ekonomik mbi fëmijën dhe të ardhmen e tij.

## 10. BIBLOGRAFIA

- Raport Kombëtar për Shqipërinë mbi Progresin për Arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Mijëvjeçarit, agjencia e KOB-se në Shqipëri dhe PNUD, Tiranë 2004.
- Volume 1 South-Eastern in Europe, Denied a Future? The Right to Education of Roma/Gypsy & Traveller Children in Europe, Save the Children.
- Time- Bound programme, Manual for Action Planning, International Programme on the Elimination of Child Labour.
- CRCA “Rrethi Vicioz”, Studim mbi situatën e punës së fëmijëve në Shqipëri, Tiranë 2000.
- Child Trafficking-The People Involved, A synthesis of Finding from Albania, Moldova, Romania and Ukraine, International Programme on the Elimination of Child Labour, 2005.
- Eliminimi i Formave me të Keqja të Punës së Fëmijëve, Udhëzues praktik për Konventën Nr 182, të ILO-s, Zyra IPEC në Tiranë, 2002.
- Working Children: Reconsidering the Debates, Report of the International Working group on Child Labour, Defence for Children International, International Society For the Prevention of Child Abuse and Neglect, 1998.
- Psychosocial impacts of child work: a framework for research, monitoring and intervention, Martin Woodhead, February, 2004, ILO, UNICEF, World Bank Group.
- The Child Labour Problem, Issues and Solutions, G. K. Lietaen (ed.), Defence for Children International, International Children’s Rights Monitor, 2004.
- Child Labour In Europe And Central Asia: International Programme on the Elimination of Child Labour International Labour Organization, an overview of Selected Countries, Geneva, 2003.
- Puna e Fëmijëve dhe Legjislacioni Shqiptar, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale, Tiranë, 2005.
- Strategjia Kombëtare për Fëmijët në Shqipëri, 2005-2010, Tiranë 31 Maj 2005,
- Strategjia Kombëtare në Luftë Kundër Trafikut të Fëmijëve në Shqipëri, VKM Nr. 171, Datë 11.2.2005, Tiranë.
- Abuzimi i Fëmijëve në Familje, CRCA, Dhjetor 2005, Tiranë.
- Një Botë e Denjë për Fëmijët, UNICEF, Qershor 2005.
- Njerëzit dhe Puna, Krahu i Punës, Punësimi dhe Papunësia, INSTAT 2004.
- Banka Botërore, Raport No. 26213-AL, Shqipëria: Vlerësimi i Varferisë.
- Banka Botërore, Strategjia e Asistencës për Shqipërinë 2003-2005.
- Manuali i Trainimit “Puna e Fëmijëve dhe Format më të rënda të saj” CRCA- ILO, Tiranë, Shtator 2001



# **ANEKS I**

## **RASTE STUDIMORE**

## Rasti : G. I.

G.I. është djali i dytë i familjes, ai ka një vëlla më të madh dhe një motër më të vogël se vetja. Vëllai i madh vuan dënimin në burg për shkak të disa shkeljeve të ligjit që kish bërë në gjendje të pirë. Babai i Gentit punon ndërsa nëna e tij qëndron në shtëpi.

Genti ka filluar punën që në moshën 10 vjeç dhe aktualisht punon në një lavazh makinash me orar të plotë. Menyra si është punësuar G.I. është ajo me e zakonshme në këtë zonë. Duke qënë se pronari ishte një i njohur dhe për ti bërë nder e ka marrë G.I. në punë. G.I. ka ndjekur shkollën deri në klasën e shtatë. Ai fillimisht e ndiqte atë paralelisht me punën, por më pas e braktisi pa e përfunduar.

Marrëdhënia e tij me shkollën ka qënë pak delikate. Ai shprehet se e pëlqente shkollën, por nuk pëlqente të mbante librat me vete dhe thuajse gjithmonë e linte çantën në shkollë që të mos e mbante me vete. Delikate ishte marrëdhënia e tij dhe me mësuesit. Duke qënë se G.I. nuk ishte nxënësi me i rregullt dhe ndërkohë nuk pranonte asnjë kritike ai shfaqte sjellje agresive ndaj mësuesve edhe ndaj fëmijëve të tjerë. Ai në këto raste quan të justifikueshme dhe dhunën fizike ndaj mësuesve. Shprehet se ka dëshirë të vazhdojë shkollën edhe pse nuk ka asnjë plan për këtë gjë.

G.I. sillet si të ishte 20 vje dhe jo 15. Në botën e tij perfekte ai do donte të kishte një punë të tijen ku të mund të punonte vetëm dhe të mos të ketë të bëjë me njeri. Kur është tek Klubi i Fëmijëve program i CRC, atij i pëlqente të jetë në qëndër të vëmendjes dhe është në kërkim të vazhdueshëm të vëmendjes. Është disi dyshues për çdo gjë që ndodh rreth tij. Nuk ka një shoqëri të zgjeruar, një ose dy shok të ngushtë dhe nuk tenton të krijojë shoqeri të re.

G.I. viziton në mënyrë të rregullt vëllain e tij në burg se bashku me nënën e tij dhe duket se e merr malli për të dhe pavarësisht nga fakti që është në burg shfaqet si një figurë referimi për G.I. I pëlqen shumë të punojë dhe duke punuar në servis makinash ka mësuar role të ndryshme pune që kanë të bëjnë me rregullimin e makinave. G.I., çfarë di sepse e ka mësuar nga eksperiencia e vet dhe sjelljet alternative janë për të jorealiste.

## Rasti E. L.

Familja e E.L. ka ardhur në Tiranë 11 vjet me parë. Ajo përbëhet nga pesë persona. Babai i E.L. është tregtar. Nëna e tij gjithashtu punon ajo bën një punë të thjeshtë, por ai preferon të mos ta tregojë dhe thjesht ta paraqes si shtëpiake. Nga mënyra si po tentonte ta shpjegonte punën e saj ngjante si një punë zakonisht e bërë prej burrash, ndaj dukej se ai ndjehej në siklet për këtë. Vëllai i E.L. është 12 vjeç dhe ndjek mësimet në të njëjtën shkollë me E.L. Ai është gjithashtu frekuentues i rregullt i Klubit të Fëmijëve. E.L. ka dhe një motër tre vjeçe më të cilën është shumë i lidhur. E.L. është fëmija i madh në familje.

Gjatë muajve të verës E.L. punon rregullisht me babain e tij në treg. Ndërkohë gjatë kohës së shkollës ai vazhdon të punojë pas mësimit ose gjatë fundjavës. Gjatë kohës që babai i tij bën furnizimin, ai e menazon vetë tezgën e tij. Gjatë pjesës tjetër të kohës ai ndihmon babain e tij. Punën nuk e konsideron shumë të lodhshme. Është për t'u theksuar se interesi i tij për shkollën nuk është shumë i madh, por edhe puna nuk përbën interes për të përveçse, i pëlqen që të ketë paratë e tij dhe këtë ja ka theksuar me shumë babai i tij. Babai i tij i jep pak para nga ato që ai fiton gjatë punës. Marrëdhëniet me babain e tij nuk janë shumë të mira. Ai është shumë autotaritar deh shpesh ushton dhunë nëse E.L. nuk i bindet. Edhe me nënën gjithashtu nuk shkon. Ao nuk e përkrah atë dhe i bërtet herë pas here. Kjo gjë E.L. e bën keq. Ai është një djalë mjaft krenar ndaj shpesh siç është e zakonshme në këtë lagje, grindet me të tjerët për të mbrojtur nderin dhe imazhin e tij. Me vëllain nuk

janë shumë të afërt sepse shpesh zihen, por gjithsesi kur është nevoja kujdeset për të. Të mësohet si të menazhojë në mënyrë më të sukseshme situatat që me parë e kanë cuar në grindje. Ndërgjegjësimi për të drejtat e tij dhe si mund ti mbrojë ato.

## **Rasti I.G.**

I.G. është fëmija me i vogël në familje. Ai ka një motër dhe tre vellezër më të mëdhenj. Familja e Izmirit është zhvendosur 15 vjet me parë në Tiranë ku dhe lindi Izmiri. Babai i tij është me prejardhje nga veriu i Shqipërisë. I.G. ka dy vëllezer që ndodhën në burg; njeri 24 vjeç dhe tjetri 19 vjeç. Të dy janë të dënuar me shumë vite burg sidomos vëllai 19 vjeçar duhet të kalojë edhe 18 vjet të tjera në burg. Rreth një herë në muaj shkojnë ti bëjnë vizita vëllezerve në burg. Vëllai tjetër është 18 vjeç dhe punon në një zdrukhtari. Motra është 13 vjeç dhe tashmë ka braktisuar shkollën dhe merret me punët e shtëpise.

Vete I.G. punoin duke hedhjen e tallazhit tek plehrat. Për këtë ai merr rreth pesë mijë lekë në ditë dhe këto para ia jep babait të tij. Personi ku ai punon ka aktivitetin pranë lagjes së I.G. dhe kanë rënë dakort për këtë lloj punësimi. I.G. punon nga ora 8:30 deri në 16:00, pra katër orë. Ai e konsideron punën të lodhshme por nuk ka se çfarë të bëjë babi i tij e rref nëse nuk punon.

Gjëja e parë që bie në sy tek I.G. është mosperputhja mes moshës së tij dhe përmasave të tij fizike. Ai është shumë i shkurtër dhe i vogël në trup për moshën që ka. I.G. gjatë pjesës më të madhe të ditës është në punë pas punës shkon rri me shokët e lagjes të cilët janë më të mëdhenjë se ai.

Shembjuti e vëllezerve të tij kanë ndikimin e vet tek I.G. dhe në një farë mënyre kondicionojnë mënyrën me të cilën ai edukohet duke e vënë atë në risk. Në klubin e fëmijëve sjellja e tij është shumë e mirë dhe socializimi i tij me shokët e tjerë është i kënaqshëm, por ai nuk e frekuenton shpesh dhe në mënyrë të përditshme klubin sepse i duhet të punojë dhe pronari nuk i jep leje ose pushim.

Në klubin e fëmijëve I.G. gjen një ambient ku përveçse ndërgjegjësohet për të drejtat e tij, luan dhe socializohet me fëmijët e tjerë, gjen dhe një ambient të mbrojtur ku ka njerëz që përkujdesen për të.

## **RASTI A. K.**

Familja e A.K. është e përbëre nga shtatë persona dhe ai është më i vogli i tre vëllezerve. Babai i A.K. për momentin nuk është shumë i stabilizuar me punë. Ai merret me rregullimin apo montimin e sobave të drurit, si dhe rregullime të tjera të vogla nëpër shtëpi. Nëna e A.K. është shtëpiake. Duke qënë se familja e tij është mjaft patriarkale dhe nënës nuk i lejohet të punojë. Njëri nga vëllezrit A.K. është 19 vjeç dhe punon në lavazhin e vet. Kjo familje është zhvendosur në Tiranë para 11 vjetesh. A.K. ka pasur edhe një vëlla tjetër i cili ka vdekur në moshën 22 vjeçare. Ai vdiq si pasojë e një grindje banale me një moshatar të së njëjtës lagje i cili tashmë ndodhet në burg.

A.K. prej dy vjetësh ka punuar rregullisht në lavazhin e të vëllait. Gjatë verës ai punon ditë për ditë nga ora 7:00 deri në 18:00, pra për 11 orë në ditë kurse gjatë dimrit punon më pak rreth 8 orë. Ai e cilëson punën shumë të lodhshme dhe përveç kësaj ai përballet me situata në të cilat klientët nuk tregohen korrekt me pagesën ose jo të respektueshëm, për rrjedhojë në vendin e punës fillojnë grindje ku përdoren edhe armë të ftohta. Arsyeja pse ai punon është sepse kështu ka menduar babai i tij si mënyra për të shmangur kthimin e A.K. nga “ruga” sipas cilësimeve të tij. Kur A.K. pyetet pse punon përgjigjia e tij është “ se nuk jam rrugaç unë të rri rrugëve kot”. Në

një farë mënyre ai ndjehet i vlerësuar nga familja për faktin që punon dhe mban shtëpinë. Marrëdhëniet e A.K. me vëllezërit janë në përgjithësi të mira edhe pse ai shprehet se ka qënë shumë i lidhur me vëllain që i ka vdekur. Vëllezërit e tij të mëdhenj janë shprehur se sapo të dalë nga burgu personi i cili ka vrarë vëllain e tyre ato do të hakmerren menjëherë. Për fat të keq kjo është si një pritshmëri që njerëzit në përgjithësi kanë ndaj tyre, dhe A.K. mendon të njëjtën gjë.

Marrëdhëniet e Arbërit me nënën e tij janë të mira pasi ajo përkujdeset për të. Megjithatë duhet thënë se femra është shumë pak e vlerësuar në familjen e tij aq sa A.K. ndjehet me fat që nuk ka një motër sepse ato nxjerrin “ngatërresa”, duke nënkuptuar me këtë çështje nderi apo morali. Marrëdhënia me babain është jo e mirë por e pranueshme për A.K. aq sa ai shprehet se “sillem mirë me të se më rreh”.

## **Rasti E.B.**

Familja e E.B. është zhvendosur në Tiranë para 12 vjetësh. Ajo ka pesë pjesëtare, babai i E.B. nuk punon që prej 12 vjetësh. Kjo është dhe periudha që kur ai është i paafte të punojë për shkak të një sëmundje të rëndë që e ka prekur. Në qoftë se ai punon rrezikon të humbë jetën. Të vetmet punë që ai mund të kryej janë punët e lehta që nuk kërkojnë asnjë sforcim fizik, por ai nuk ka përgatitjen e duhur profesionale për të kryer këto lloj punësh. Para sëmundjes ai ishte këpucar. Për momentin nëna e E.B. nuk punon. Pak kohë me parë ajo sapo kishte filluar punë si rrobaqepese, por e humbi menjëherë këtë punë për shkak të krizës energjitike në të cilën u gjet vendi dhe shkurtimeve që u bënë si rrjedhojë e saj. E.B. ka një vëlla 15 vjeçar i cili jeton në Greqi. Ai është larguar që në moshën 12 vjeçare së bashku me dajën e tij. Aktualisht merret me vjeljen e pemeve në pronën e pronarit të tyre. Ai siç thotë E.B. nuk na dërgon asnjë lekë. Vëllai tjetër i Enisit është 10 vjeç dhe vazhdon klasën e pestë. E.B. ka edhe një moter 5 vjeçe e cila frekuenton kopshtin.

Nga që nuk isha çtëe bëja thotë E.B.nisa të punoja që 9 vjeç. Në fillim duke shitur bajame në rrugë dhe tani kemi nxjerrë një tavolinë me mallra të ndryshme e vënë në derën e shtëpisë së tyre. Gjatë verës ai punonte në orarin 10:00 me 20:00 ndërsa në dimër 08:00 me 17:00. Ai nuk e sheh punën si shumë të lodhshme, por mërzhitet shumë në orët e gjata në të cilat atij i duhej të qendronte aty dhe me faktin që nuk ka mundësi të rritet si fëmijët e tjerë. Pak kohë me parë ai u sëmurë për shkak se ishte ftohur në vendin e punës dhe si pasojë u shtrua në spital për disa kohë gjë që i kushtoi financiarisht familjes. Si pasojë e kësaj ngjarje dhe të faktit që dyqani (tavolinën) nuk sillte fitime ato vendosën ta mbyllin atë. Kjo bëri që E.B. të kërkonte një punë tjetër. Puna tjetër që ai bën është lidhur me një që punon gipse dhe është ndihmësi i tij, kur skanë punë dalin tek “Ushtari i Panjohur” dhe punojnë çfarë t’u dali.

# **ANEKS II**

## **LISTA E PERSONAVE TE INTERVISTUAR**

## **LISTA E PERSONAVE TE INTERVISTUAR NE NIVELIN E INSTITUCIONEVE DHE ORGANIZATAVE**

- 1. Prof. Nikoleta Mita, studiuese dhe petagoge, Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale.**
- 2. Z. Gezim Tusha, Zv. Drejtor i Administrates se Pergjithshme te Shërbimeve Sociale, Tirane.**
- 3. Znj. Zana Sakiqi, Drejtoreshe e organizates “Every Child”, Tirane.**
- 4. Znj. Lume Cici, Juriste e Inspektoriatit te Lartë te Punës, prane Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, Tirane.**
- 5. Znj. Shkëlqesa Manaj, Njësia Kunder Punes se Femijes, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Tirane.**
- 6. Znj. Snezhi Bedalli, Zyra e ILO-IPEC në Shqipëri, Tirane.**
- 7. Z. Bilbil Jaupi, Zyra Rajonale Tiranë.**
- 8. Znj. Anola Shala, Sektori i Mbrojtjes të të Miturve, Ministria e Drejtësisë, Tirane.**
- 9. Znj. Eleni Laperi, Drejtoreshe, Qendra Kulturore Lindart, Tirane.**
- 10. Z. Leonrd Guni, Koodinator i Qendrës Fëmijët e Botës të Shqipërisë- Te Drejtat e Njeriut, Tirane.**
- 11. Z. Skënder Veliu, Drejtor i Unionit te Romeve Amaro–Drom, Tirane.**
- 12. Znj. Sonila Agolli, Drejtoreshe Programi, i organizatës ‘Alternativa Profesionale’, Tirane.**
- 13. Znj. Drita Teta, Kryetare e Komitetit për Shanse të Barabarta, Tirane.**
- 14. Z. S. Thornton Barkley, Bashke-drejtor i Qendra per Mbrojtjen e te Drejtave te Femijeve ne Shqiperi (CRCA) dhe ekspert per çështjen e administrimit te drejtesise per te mitur.**

Njoftim per Copyright-in

E gjithë permbajtja e këtij botimi është copyright © 2005  
i Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri (CRCA)  
(CRCA 2005 – Tirane / Shqipëri)

Te gjithë lexuesit janë të lejuar të printojnë, kopjojnë ose shpërndajnë pjesë të këtij botimi, por gjithmone duke bërë të qartë dhe duke i dhënë atributin Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve në Shqipëri - CRCA. Asnjë pjesë ose i gjithë botimi nuk mund të botohet ose shitet pa lejen me shkrim të CRCA.

*Opinionet e shprehura në këtë botim jo detyrimisht shprehin ose përfaqësojnë politikën ose opinionet e CRCA ose ato të donatoreve.*

**Financuar nga: Palme Center dhe SIDA**

**Botuar nga CRCA, Tirane 2005**